

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7601 E enjte 26 Korrik 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nga AGUSTIN PALOKAJ

A ju kujtohet se kush ishte autor i thënies "Pakoja e Ahtisaarit është kompromisi ynë". Këtë e kishte thënë presidenti i sotëm i Kosovës, Hashim Thaçi ...
Vijon në faqen 20

Loja e Hashim Thaçit për një sakrificë të rëndë për Kosovën



Opinion

Ditës

Nga GJERGJ EREBARA

Kryeministri Edi Rama prej javësh ka nisur publikimin e disa videoanimacioneve në faqen e tij në 'Facebook' për të prezantuar projektet e tij për ndërtimin ...
Vijon në faqen 21

Si u shpenzuan 20 miliardë lekë për ndërtim rrugësh vitin e kaluar



Drejtesia, Rama: Nisi pastrimi i llumit

Vlahutin: Grupe te caktuara bënë përpjekje shantazhi kundër "reformës"

Berisha: Magjistratura, maxhoranca joshi e bëri oferta të pista për deputetët e PD

Ambasadorja e Bashkimit Evropian në Tiranë, Romana Vlahutin rrëfeu për "Deutch Welle" sfidat e mandatit të saj 4-vjeçar në Shqipëri. E pyetur në lidhje me vështirësitë që ka hasur gjatë mbështetjes së reformës në drejtësi, Vlahutin u shpreh: "Sfida më e madhe ishte padyshim antagonizmi i brendshëm politik dhe interesat ...
Në faqen 2

KESHILLI I BASHKIAK SHQYRTON SOT PROJEKTVENDIMET ME KARAKTER SOCIAL

KOMPENSIMI PER ENERGJINE, KUSH E PERFITON NE TIRANE

Kategoritë në nevojë, familjet që marrin 2 mijë dhe 1.400 lekë sipas njërive bashkiake. Vendimi tjetër, 3200 familje do të marrin ndihmë ekonomike



(Në foto) Këshilli Bashkiak i Tiranës

Në faqen 7

PASOJAT E FLAKEVE

81 të vdekur nga zjarri në Greqi, ambasada jonë në Athinë: 3 shqiptarë
Në faqen 22

VENDIMI I KPK

Vetingu gjec Rovena Gashin, kalojnë Ardian Dvorani dhe Astrit Faqolli
Në faqen 5

KESHILLAT E MJEKUT

Ylli Merja: Efektet kurative të "bimës së trurit", ja si përgatitet çaji
Në faqen 10

VENDIMI

Tapia e trullit për 600 ndërtime, lista e përfutuesve në të gjithë vendin
Në faqen 11-12

"SUMMER PAGES"



Stresi dhe Kejsi rrëfejën dashurinë: 2 javë në arrati dhe celebrimi pa bujë
Suplement

Zgjerohet harta e bashkëpunimit me ndërkombëtarët, më shumë mundësi për studentët

"Luarasi", marrëveshje me Universitetin e Barit

Rektori Et'hem Ruka: Pakti forcon urën që lidh dy anët e Adriatikut

Nga VOLTIZA DURO

Kolegji Universitar "Luarasi", një ndër institucionet më prestigjioze të arsimit të lartë në vend ka nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit me një universitet të rëndësishëm në Itali. Kështu, viti i ri



akademik 2018-2019 do të ofrojë më tepër mundësi për studentët, e projekte ambicioze që pritet të realizohen në bashkëpunim me universitetin e Barit "Aldo Moro". Ky i fundit me 50 mijë studente dhe mbi 2000 pedagoge ...
Në faqen 8

INTEGRIMI INTERVISTA

Ambasadorja e BE-së tregon sfidat e mandatit 4-vjeçar, pak para largimit

"Drejtësia", Vlahutin: Grupe të caktuara u përpoqën të kërcënojnë e bëjnë shantazh "Shqipëria, një popull thellësisht evropian"

Ambasadorja e Bashkimit Evropian në Tiranë, Romana Vlahutin rrëfeu për "Deutch Welle" sfidat e mandatit të saj 4-vjeçar në Shqipëri. E pyetur në lidhje me vështirësitë që ka hasur gjatë mbështetjes së reformës në drejtësi, Vlahutin u shpreh: "Sfida më e madhe ishte padyshim antagonizmi i brendshëm politik dhe interesat personale të grupeve, që në mënyrë konstante u përpoqën të kërcënojnë, bëjnë shantazh, të ulin dhe sulmojnë përpjekjet për reformat, qoftë kjo reforma në drejtësi, lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, financat publike. Gjithsesi, njëherazi, përpjekjet për të parandaluar ose bllokuar reformat ishin prova më e mirë që këto reforma ishin jashtëzakonisht të nevojshme dhe në interesin më të mirë të axhendës shqiptare të BE-së".

Znj. Ambasadore Vlahutin, Komisioni Europian dhe qeveria e Shqipërisë kanë filluar këtë javë procesin e vlerësimit analitik ose screening për reformat dhe rezultatet e tyre të deritanishme në Shqipëri. Cilat janë pritshmëritë e Komisionit nga ky proces, në kuadër të angazhimit të tij për të mbështetur Shqipërinë në hapjen e negociatave të pranimit në BE, në qershor 2019?

Screening është një fazë shumë e rëndësishme përgjatë procesit të negociatave dhe BE të mund të përgatisin kuadrin e negociatave. Ky proces i shërben si autoriteteve kombëtare, ashtu edhe shërbimeve të Komisionit Evropian (KE) për të vendosur në 90 ditë cilat elemente legjislativë kombëtarë i Shqipërisë është i ndryshëm nga ai i BE-së, çfarë ndryshimesh do të duhet të miratohen për afërsimin e tij me Acquis të BE. Pra, me fjalë të tjera, screening do të vendosë të gjitha ndryshimet, që ende duhet të ndodhin, sepse kur Shqipëria të fillojë zyrtarisht negociatat? do ligj, para se të miratohet në parlament, duhet më parë të dërgohet në shërbimin e rëndësishëm në Bruksel, që ky shërbim të jetë i sigurtë se ligji është në linjë me Acquis.

Presidenti i Këshillit Evropian, Donald Tusk, u bëri kohë e fundit thirrje forcave pro-perëndimore të Shqipërisë që të bash-



Ambasadorja e Bashkimit Evropian në Tiranë, Romana Vlahutin, dhe një gazetare

këpunojnë për të arritur hapjen e negociatave vitin që vjen. Cilat forca janë pro-perëndimore në Shqipëri?

Nga përvoja ime në vend, pro-perëndimor, nëse doni thellësisht evropian, është identiteti i shqiptarëve, baza më e fortë e mundshme për të gjitha ambicjet shqiptare për t'iu bashkuar BE-së. Mbështetja e qytetarëve të Shqipërisë ndaj bisedimeve të pranimit dhe anëtarësimit.

Kundërshtitë

"Ndërkohë ka pasur dhe ende ka shumë përpjekje, nga ata që kundërshtuan reformën për shkak të interesave vetjake, që e sulmuan atë me mjete të ndryshme, por që dështuan. Sistemi i ri i gjyqësorit është tani një realitet kushtetues. Pati humbje kohe për shkak të atyre përpjekjeve të dështuara dhe grindjeve politike, por edhe këto të fundit janë pjesë e procesit", -tha Vlahutin.

it në BE është e padiskutueshme, madje edhe më shumë se kaq: të gjithë shqiptarët luftojnë për liri, duke përfshirë edhe luftën kundër diktaturës komuniste të Enver Hoxhës,

luftojnë me kurajë dhe dëshirë të thellë për ta pasur kombin të tyre pjesë të komunitetit të kombeve evropiane. Ky identitet shumë i qartë evropian e bën Shqipërinë, gjithashtu, një partner të besueshëm dhe të besuar në NATO dhe gjithë politikët e jashtëm të sigurisë të BE.

Çfarë mund ta kërcënojë ritmin e vazhdimin dhe thellësinë të reformës në drejtësi? Deri në qershor 2019 ka mbetur më pak se një vit dhe reforma deri tani ka pasur vonesa të vazhdueshme.

Nuk pajtohem disa me nocionin e vonesave, sepse kur shikon objektivisht këtë reformë ajo është vërtet mahnitëse: kaq gjithëpërfshirëse, që kërkoj ndryshimin e 1/3 së Kushtetutës, miratimin e 40 ligjeve të reja, që realizoi një ridizenjim të plotë të sistemit, duke përfshirë vettingun dhe ngritjen e institucioneve të reja, që nisi nga zeroja vetëm 3 vjet më parë. Në vende të tjera edhe reforma më të vogla marrin më shumë kohë. Sot jemi dëshmitarë të progresit të rëndësishëm të vettingut dhe lista prioritare duhet të përfundojë aty nga fundi i shtatorit. Ajo do të krijojë mundësinë për ngritjen e institucioneve të reja të vetëqeverisjes së gjyqësorit,

që Këshilli i Lartë i Gjyqësorit dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë të fillojnë funksionimin e tyre. Ndërkohë ka pasur dhe ende ka shumë përpjekje, nga ata që kundërshtuan reformën për shkak të interesave vetjake, që e sulmuan atë me mjete të ndryshme, por që dështuan. Sistemi i ri i gjyqësorit është tani një realitet kushtetues. Pati humbje kohe për shkak të atyre përpjekjeve të dështuara dhe grindjeve politike, por edhe këto të fundit janë pjesë e procesit. Natyrisht, në një reformë kaq gjithëpërfshirëse, të duhet të presësh edhe momente të vështira, por e rëndësishme është që njerëzit kuptojnë se kjo reformë është vendimtare për shqiptarët dhe se nuk është e mundur të ndryshosh në pak muaj atë që është shkatërruar për dekada të tëra.

Në fillim të këtij muaji, në Samitin e Londrës, në kuadër të investimeve në Ballkanin Perëndimor (BP), KE shpalli Instrumentin e ri garantues për BP. A mund të jetë ky instrument një Plan Marshall i BE për rajonin edhe pse kemi të bëjmë me dy instrumente të ndryshëm në kohë dhe objektiva: Plani Marshall financoi me 13 miliardë dollarë, nga 1948-1951 rimëkëmbjen

ekonomike të Europës pas Luftës së Dytë Botërore, kurse KE planifikon të financojë me 1 miliard euro rajonin, për një periudhë të papërcaktuar?

Mendoj se nuk mund dhe nuk duhet të krahasojmë 1948 me 2018, sepse shumë gjëra janë ndryshe. Tanimë, kuadri i investimeve në Ballkanin Perëndimor (BP) ka siguruar shumë mbështetje dhe instrumenti ri garantues është një shtim i shkëlqyer i kësaj mbështetjeje. BE është duke punuar dhe investuar në vendet e BP, në kuptimin e plotë të fjalës, në të gjitha fushat, që nga qeverisja e mirë deri tek infrastruktura. Por nuk është vetëm një investim në

Sfidat

"Sfida më e madhe ishte padyshim antagonizmi i brendshëm politik dhe interesat personale të grupeve, që në mënyrë konstante u përpoqën të kërcënojnë, bëjnë shantazh, të ulin dhe sulmojnë përpjekjet për reformat, qoftë kjo reforma në drejtësi, lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, financat publike", -tregoi ambasadorja.

vende të veçanta, është një investim në stabilitetin e rajonit dhe të BE, gjithashtu, përdërisa vendet e BP janë një pjesë e pandarë e sigurisë sonë të përbashkët dhe sferës ekonomike. Plani Marshall ishte një përpjekje për rindërtim pas lufte dhe pati rezultate jashtëzakonisht të mira. Jo vetëm për ekonominë, por, në radhë, të parë për pagën dhe stabilitetin. Investimi në BP është një investim i vazhdueshëm në tërë Europën, e lirë dhe në paqe.

Znj. Vlahutin, ju plotësoni në fund të këtij gushti, kohën e detyrës suaj si ambasadore e Delegacionit të



BE në Shqipëri. Brenda katër viteve të kësaj detyre, filloi dhe eci zbatimi i reformës në drejtësi, nisi dhe po vazhdon vettingu për gjykatësit dhe prokurorët, Shqipëria ka një datë për hapjen e negociatave të pranimit në BE, nëse do t'i bëjë detyrat e shtëpisë. Si i shihni në tërësi vitet që keni kaluar në Shqipëri në detyrën e ambasadores?

Jam shumë e lumtur dhe krenare që ia dolëm mbanë të gjithë bashkë, dua të them institucionet e Shqipërisë dhe shoqëria civile, ambasadorët e shteteve anëtare të BE, kolegët e SHBA, gjithë shërbimet e BE-së që u përfshinë për të realizuar këtë reformë thellësisht të rëndësishme dhe që patëm një mbështetje shumë të madhe nga shqiptarët, gjatë gjithë kohës, në mënyrë konstante të më shumë se 90% të qytetarëve të Shqipërisë. Drejtësia është një gur themeli për çdo demokraci funksionale. Asnjë reformë tjetër nuk mund të zbatohet realisht para se të kesh një sistem drejtësie të pavarur, të përgjegjshëm dhe të aftë. Gjatë katër viteve të mia në Shqipëri punuam shumë për të gjallëruar dhe forcuar punën e shoqërisë civile dhe qeverisjes vendore. Natyrisht u angazhuam edhe në të gjitha reformat e tjera në veçanti në ato që lidhen me zbatimin e ligjit në përgjithësi, luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit, me reformën në administratën publike dhe mbrojtjen e të drejtave themelore. Pashë rezultatet e angazhimit tonë me publikun dhe është vërtet interesante kur sheh që përgjigja e medias së vërtetë sociale ndaj punës sonë është rritur



1000 %. Kjo do të thotë se nuk flasim dhe nuk punojmë më kot, njerëzit kanë njohur dhe kuptuar ndryshimin që integrimi evropian sjell në cilësinë e jetës së tyre të përditshme. Personalisht për mua kjo është shumë e rëndësishme: që qytetarët të shikojnë dhe të kuptojnë plotësisht që BE është një forcë e ndryshimit për më mirë.

Cila është sfida më e madhe gjatë detyrës tuaj në Shqipëri si ambasadore e BE-së? Cilat janë përvojat më të mira që do merrni me vete?

Sfida më e madhe ishte padyshim antagonizmi i brendshëm politik dhe interesat personale të grupeve, që në mënyrë konstante u përpoqën të kërcënojnë, bëjnë shantazh, të ulin dhe sulmojnë përpjekjet për reformat, qoftë kjo reforma në drejtësi, lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, financat publike. Gjithsesi, njëherazi, përpjekjet për të parandaluar ose bllokuar reformat ishin prova më e mirë që këto reforma ishin jashtëzakonisht të nevojshme dhe në interesin më të mirë të axhendës shqiptare të BE-së. Për sa i përket përvojave të mia më të mira: do të duhej shumë hapësirë për t'i listuar. Por do të thosha, mbi të gjitha, përvoja nga njerëzit të mrekullueshëm, shumë punëtorë, të ndershëm dhe të men'ur që i takova kudo, dhe veçanërisht nga gratë e jashtëzakonshme, fenomenale të Shqipërisë. Çdo takim i tillë i jep një kuptim, vlerë më shumë, gjithë sa po bëjmë në Shqipëri, sepse në fund të fundit, të gjitha reformat kanë një qëllim thelbësor: ta bëjnë më të mirë jetën e njerëzve.

Intervistoi: Ani Ruci



U shkarkua nga vetingu, Kuvendi shpall vakancën vendin e anëtarit të Kushtetueses, Fatos Lulo

Kuvendi ka shpallur vakancën për anëtar të Gjykatës Kushtetuese për plotësimin e vendit të lënë bosh nga ish-gjyqtari Fatos Lulo, i cili u shkarkua nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Në njoftimin e Kuvendit thuhet se: "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, me qëllim plotësimin e "vakancës së parakohshme" të krijuar për shkak të mbarimit para afatit ligjor të mandatit të z.Fatos Lulo, shpall hapjen e procedurës së aplikimit për vendin vakant për i anëtar të Gjykatës Kushtetuese." Sipas njoftimit të Kuvendit, Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që ka kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit, por edhe që ka përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike.

Kryeministri: Pastrimi i llumit ka nisur, në opozitë njëri i bie gozhdës, tjetri patkoit

Magjistratura, BE-partive: Tejkalojnë bllokimet, seancë të jashtëzakonshme

Gjonaj: Bllokimi i ndryshimeve përpëlitje e opozitës

Darina Tanushi

Delegacioni i BE në Shqipëri i bën thirrje partive politike që të tejkalojnë situatën e ngërçit, të krijuar nga mosvotimi i ligjit për Shkollën e Magjistraturës. "BE-ja i bën thirrje partive politike të tejkalojnë bllokimet dhe të amendojnë ligjin, ose në një seancë të jashtëzakonshme, ose me përparësi kur Kuvendi të mbledhet përsëri në shtator", thuhet në reagimin e misionit të BE-së për 'Ora News'. Delegacioni i BE sqaron, gjithashtu, se formimi i gjykatësve dhe prokurorëve të rinj është më i rëndësishëm se kurrë, ndërsa shpreh keqardhje që partitë politike në Shqipëri nuk arrijn marrëveshje lidhur me ndryshimet e nevojshme në ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. "Formimi i gjykatësve dhe prokurorëve të rinj është më i rëndësishëm se kurrë, kur marrim parasysh se si pasojë e procesit të vetingut, një numër i caktuar gjykatësish dhe prokurorësh po shkarkohen nga detyra dhe duhet të zëvendësohen. Shprehim keqardhje që partitë politike në Shqipëri nuk arrijn marrëveshje lidhur me ndryshimet e nevojshme në ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, lidhur me rekrutimin e kandidatëve për formimin fillestar gjatë vitit akademik 2018-19", thuhet në reagim. Ndërkohë në një status në Facebook, kryeministri Rama u shpreh mbremë: "Fiks dy vjet më parë kaloi pas njëmijë qametesh reforma në drejtësi. Sot pastrimi i llumit të madh ka nisur pa ndalim. Ndërsa ata njësoj si atëherë i bien njëri gozhdës e tjetri patkoit dhe po njësoj SHBA-BE u kërkojnë t'i thërrasin mendjes. Sa gjynah për këdo i beson e dëgjon ende!".

MINISTRJA E DREJTËSISË

Ndërkohë më herët, ministria e drejtësisë Etilda Gjonaj siguroi të gjithë qytetarët se "bllokimi i ndryshimeve ligjore për Shkollën e Magjistraturës, ishte një përpëlitje sa e dëshpëruar, aq edhe e pashpresë për të kthyer mbrapsht reformën në drejtësi. Kjo nuk ka për të ndodhur kurrë dhe ne do të jemi deri në fund, garantë e palëkundur të një reforme që po bën histori në rrugën e drejtësisë shqiptare. Asgjë dhe askush nuk e bllokoi dot më këtë rrugë". "Asgjë nuk është jashtë parashikimeve tona, përf-



Ministria e Drejtësisë, Etilda Gjonaj

ETILDA GJONAJ

"Asgjë nuk është jashtë parashikimeve tona, përfshirë edhe këto vonesa artificiale të krijuara nga një opozitë artificiale! Askush nuk është mbi ligjin dhe askush nuk ka për të dalë dot mbi ligjin, duke kërcënuar, shantazhuar e bllokuar për të imponuar ndryshimin shkatërrues të ligjeve tashmë të miratuara", - tha dje, ministria.

Ligji për magjistratët, ish-kryeministri akuzon Ramën

Berisha: Mazhoranca joshi e përdori oferta të pista për të blerë votat e opozitës

Ish-kryeministri Sali Berisha ka reaguar në lidhje me bllokimin e ligjit të Magjistraturës dhe ngërçit që është krijuar në gjykatat e vendit. Berisha me anë të një postimi në Facebook e cilëson këtë ligj si ligjin e mafias së ardhshme të drejtësisë, ndërsa shton se ai do ta shndërronte Magjistraturën në shkollë partie. "Ligji, siç faktojnë dokumente të pakundërshtueshme dhe origjinale të publikuara në media, shndërronte shkollën e magjistraturës tashmë shkollë partie në një aneks të fondacionit 'Qemal Stafa', i cili në faqen e tij zyrtare ka hapur konkurse për rekrutimin e shërbëtorëve be-

GAZMENT BARDHI

Deputeti demokrat Gazment Bardhi tha dje, se Rama po zhbën reformën në drejtësi dhe nëpërmjet këtij ligji po kthehet prapa tek institucionet e kalbura të drejtësisë. "Ky ligj nuk është për studentët. Rikthimi i Ramës tek këto institucione, pengon Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe të Prokurorisë që luftojnë korrupsionin", tha Bardhi.

shnikë të partisë për sistemin e drejtësisë", shkruan Berisha. Sipas tij, mazhoranca "përdori joshje e presione, oferta të pista, shuma marramendëse të parave të drogës dhe krimit për të siguruar 84 votat për kalimin e ligjit të saj, por dështoi. Kjo ishte një fitore e vërtetë për qytetarët shqiptarë, së pari, sepse ky ligj ishte ligji i mafias së ardhshme të drejtë-

sisë", u shpreh Berisha. Berisha shtoi se "rekrutimi, sipas këtij ligji do bëhej bazuar në kriteret e mafias nga cellula e kuqe e narkoshtetit në shkollën e magjistraturës. Lista ishte bërë gati me pinjollë të narkofunksionarëve, narkogjykatësve, narkoprokurorëve dhe krimi- nëlëve të tjerë të partisë siçiliste".

shirë edhe këto vonesa artificiale të krijuara nga një opozitë artificiale! Askush nuk është mbi ligjin dhe askush nuk ka për të dalë dot mbi ligjin, duke kërcënuar, shantazhuar e bllokuar për të imponuar ndryshimin shkatërrues të ligjeve tashmë të miratuara. Procesi i vetingut nuk është më për diskutim, po për zbatim. Reforma në Drejtësi nuk është më për diskutim, po vetëm dhe vetëm për zbatim. Opozita është në çdo moment e mirëpritur për të bashkëpunuar për vazhdimin, po kurrsesi për asnjë kthim mbrapa, dhe kurrsesi për të zhbërë atë që u miratua para dy vjetëve. Dhe ne jemi të vendosur për ta çuar deri në fund, si një ndër refor-

mat më të rëndësishme për të ardhmen e vendit tonë në rrugën evropiane", deklaroi ministria Etilda Gjonaj. Duke sjellë në vëmendje se procesi i vetingut, "po qëllohet përditë me gurët e revanshit të dëshpëruar të një opozite që pasi ka humbur pushtetin absolut mbi gjyqësorin e korruptuar deri në palcë, ka humbur edhe rrugën e arsyes". Gjonaj u shpreh "vetingu po funksionon dhe pastrimi i shumëpritur prej dekadash i Pallatit të Drejtësisë po ndodh. "Që opozita nuk e donte vetingun kjo dihet botërisht! Që opozita votoi me pahir edhe reformën në drejtësi, edhe vetingun, edhe përfshirjen e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit në Kushtetute,

edhe kjo dihet botërisht. Që opozita sot, kërkon me dëshpërim rishikimin (dmth shkatërrimin) e këtij kuadri ligjor të konsideruar botërisht si një revolucion në sistemin e drejtësisë shqiptare, edhe kjo është përditë e më e qartë. Por po ashtu, për këdo që kërkon shtet të së drejtës për gati tashmë 3 dekada, në këtë vend me një sistem drejtësie të kapur nga politika dhe të kalbur nga korrupsioni, është e qartë se kthim mbrapa nuk mund të ketë. Shantazhet e vazhdueshme, kërcënimet e përditshme, bllokimet e imagjinuara si mundësi për të imponuar kthimin mbrapa, nuk kanë asnjë mundësi të funksionojnë", - theksoi Gjonaj.

Kreu i Partisë Republika Fatmir Mediu ka reaguar pas raportit të DASH, ndërsa theksoi se nuk është çudi që vendi ynë u përjashtua nga vendet e sigurta për të investuar. Sipas Mediu raportet e DASH këto vite të fundit e përcaktojnë Shqipërinë me një nivel të lartë korrupsioni dhe të trafikëve të drogës. Teksa tha se Shqipëria mbetet një vend me risk të lartë sigurie për investitorët, Mediu renditi disa argu-



Kreu i PR-së sqaron arsyet pse DASH përjashtoi Shqipërinë

Mediu: Shqipëria, vendi me taksat dhe paqëndrueshmëri fiskale më të lartë në rajon

mente. Mes ironisë Mediu shkruan se Rama është "kryeprokuro, kryegjyqtar dhe kryepolic". "Nuk është aspak çudi që DASH përjashtoi Shqipërinë nga lista e vendeve të sigurta për investime amerikane. Raportet e

DASH këto vite e fundit e përcaktojnë Shqipërinë me një nivel të lartë korrupsioni dhe të trafikëve të drogës, pra, një vend me risk të lartë sigurie. Gjithashtu, në çdo investim të huaj garancitë për sigurinë juridike të inves-

timeve janë parakusht për çdo investitor. Në jemi vendi jo vetëm me taksat më të larta, por dhe me paqëndrueshmërinë fiskale me të madhe në rajon", shprehet Mediu në një postim të tij, në "FB". Sipas tij, ligjet që miratohen

shtojnë kontrollin korrupsiv të qeverisë në treg dhe favorizojnë kompanitë dhe klanet pranë qeverisë. "Largimi i Bankers Petroleum ose shitja tek kompani Kineze ishte sinjali më i keq për kompanitë amerikano-kanadeze Po ashtu dhe largimi i kompanisë Gjermane nga Shqipëria dhe shitja e koncesionit të aeroportit tek kinezët ishte tregues i pamundësisë për të zhvilluar biznes normal në Shqipëri",-u shpreh Mediu.

Tabaku: Qeverisja e Ramës me krimin, armiqësoi vendin me investitorët amerikanë

"Shqipëria vend i pasigurt për investime", opozita: Faj i qeverisë. DASH: Raporti ska dalë

Kreu i Grupit të LSI: Ambasada korrigjoi qëndrimin

Opozita reagoi dje, për një raport të Departamentit Amerikan të Shtetit për klimën e investimeve në Shqipëri, që sipas saj Shqipëria është renditur në vendet jomiqësore për pritjen e bizneseve amerikane. Por, pas deklaratave të shumta të përfaqësuesve të opozitës shqiptare DASH dhe ambasada amerikane në Tiranë mohuan të ketë dalë një raport i tillë. Çdo vit Departamenti Amerikan i Shtetit publikon raportin e Klimës së Investimeve. Ndërsa raporti është publikuar tashmë për një sërë shtetesh, për Shqipërinë pritet të publikohet së shpejti. Këtë e konfirmoi për "Monitor" Matthew Realph program analist në zyrën e Çështjeve të Investimeve në Departamentin Amerikan të Shtetit. "Disa prej raporteve janë në rishikim final dhe do të publikohen në javët në vijim. Shqipëria duhet të publikohet brenda 1-2 javëve"-tha ai. Sakaq në datën 23 korrik në faqen e saj zyrtare në rrjetin social "Facebook", ambasada amerikane deklaroi se ka nisur publikimin i analizave të DASH për një pjesë të mirë të vendeve lidhur me kushtet e investimeve, por se për Shqipërinë duhej ende pak kohë. "Hidhini një sy analizës së Departamentit të Shtetit mbi kushtet e investimeve në vende të ndryshme të botës (kapitulli mbi Shqipërinë do të publikohet së shpejti), e cila ndihmon në nxitjen e suksesit të bizneseve amerikane dhe ekonomisë botërore"-thuhet në postimin e ambasadës. Raporti i vitit të kaluar ishte mjaft i ashpër për Shqipërinë. Sipas tij korrupsioni në vend është shumë i lartë, ndërsa përmendte dhe faktin që sipërmarrje amerikane ishin detyruar të largoheshin nga vendi. "Pavarësisht legjislacionit të favorshëm, investi-



torët janë sfiduar nga korrupsioni i shfrenuar dhe vazhdimi i praktikave të biznesit informal. Disa investitorë në mëdhenj të SHBA-ve janë larguar nga vendi gjatë viteve të fundit pas konflikteve të vazhdueshme tregtare, përfshirë disa që shkuan deri në arbitrazh ndërkombëtar"-thuej

në raportin e vitit 2017. Raporti në fjalë është një publikim periodik që merr në analizë klimën e investimeve në 170 ekonomitë duke mundësuar kështu informacion në shtërim të biznesit. Materialet që përgatiten nga ekonomistët e akredituar brenda ambasada-ve në vende të ndryshme të

botës duke analizuar ekonomitë që mund të shihen si tregje potenciale nga bizneset amerikane.

REAGIMET

Kreu i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Socialiste për Integrim, Petrit Vasili ka reaguar pas qëndrimit të shprehur nga Departamenti

Amerikan i Shtetit dhe ambasada amerikane në vendin tonë, se raporti për klimën e biznesit në Shqipëri nuk është publikuar ende. Ndërsa ka publikuar

postimin e ambasadës amerikane të ditës së hënë, Vasili tha se vlerësojmë korrigjimin e bërë nga ambasada. Deputetja e Partisë Demokratike, Jorida Tabaku e quajti këtë një dënim për ekonominë tonë.

"Të mos jesh vend mikpritës për bizneset amerikane do të thotë se në Shqipëri ka klimë armiqësore ndaj tyre me taksat të larta, konkurrencë të pandershme nga paratë e pista të trafikut të drogës dhe korrupsionit, ka përqendrim të ekonomisë tek një grusht oligarkësh dhe klientësh të Edi Ramës. Vendimi i Departamentit Amerikan të Shtetit për të mos e konsideruar Shqipërinë si një vend miqësor për bizneset amerikane nuk është një rrufe në qiellin e hapur të një vendi të qeverisur nga narkotrafikantët dhe oligarkët",-tha Tabaku.



DITMIR BUSHATI
Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati ndodhet për një vizitë zyrtare në SHBA. Vizita e ministrit Bushati bëhet e ditur nga zyra e shtypit e Departamentit Amerikan të Shtetit. Mësohet se Bushati do të takohet në Departamentin Amerikan me Zv/Sekretarin për çështjet politike, Stephen Mull.



Katastrofa nga zjarret në Greqi, qeveria shqiptare ofron 100 mijë euro ndihmë

Qeveria shqiptare do të japë 100 mijë euro ndihmë për Greqinë pas zjarreve që përfshinë rajonin e Atikës, ku deri më tani kanë humbur jetën mbi 81 persona dhe 174 janë të plagosur. Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave fondi i ndihmës ndaj Greqisë do shërbejë për lehtësimin e pasojave të shkaktuara nga zjarret masive. Fondi do të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit. "Luftet dhe mendimet tona kanë qenë me fuqinë tanë të mirë grekë dhe për shqiptarët që jetojnë atje. Ditët e fundit kanë qenë tmerrësisht tragjike, dhe në shpresojmë që ky kontribut i joni modest, t'u vijë në ndihmë në këto kohë të vështira"-thuhet në njoftimin e qeverisë në "Twitter".

Kryetari i Kuvendit pret kreun e PD-së në Luginën e Preshevës

Ruçi me Mustafën: Lufta politike të jetë në funksion të drejtave të shqiptarëve

Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi priti dje, në takim Kryetarin e Partisë Demokratike të Luginës së Preshevës, Ragmi Mustafa. Gjatë takimit u diskutua mbi situatën në tre komunat me shumicë shqiptare të Luginës dhe shtimin e përpjekjeve e të bashkëpunimit për prosperitetin, mirë-integrimin e shqiptarëve në institucionet e qeverisjes qendrore dhe respektimin e të drejtave të tyre themelore, bazuar në standardet ndërkombëtare. Kryetari i Kuvendit Ruçi vuri në dukje se përmbushja e kërkesave të shqiptarëve

të Luginës mbetet një përparësi e posaçme e Kuvendit dhe e qeverisë së Shqipërisë. Ai përsëriti Deklaratën Politike të Aleancës së Komunave shqiptare, të datës 14 korrik, si provë e bashkimit në një zë të faktorit shqiptar të Luginës dhe artikullin i qartë të drejtave të popullsisë shqiptare në Serbi. Bashkëbiseduesit vlerësuan nevojën e rritjes së bashkëpunimit,

unifikimin e qëndrimeve e veprimeve midis të gjitha forcave politike shqiptare të Luginës dhe rritjen e pranisë së tyre në të gjithë nivelet e qeverisjes lokale e qendrore, për të shprehur e realizuar interesat e zgjedhësve të tyre. Lufta politike, këshilloi Kryetari i Kuvendit, duhet të ndahet nga përpjekjet dhe të jetë në funksion të drejtave të shqiptarëve të Luginës. Ruçi

vuri në dukje nevojën e rritjes së bashkëpunimit të forcave politike të Luginës me institucionet e Kosovës. Ai nënvizoi, gjithashtu, se Shqipëria mbështet dialogun e qytetëruar me institucionet e Serbisë, në mënyrë që shqiptarët e Luginës të përfitojnë plotësisht të drejtat që u takojnë, në përputhje me normat dhe standardet e pranuar ndërkombëtarisht.

U pezullua me urdhër të kryeprokurores Marku, Gashi nën hetim për fshehje pasurie

Vetingu, shkarkohet nga detyra prokurorja Rovena Gashi

KPK: Nuk justifikon pasurinë, ka bërë deklaram të pasaktë

Vetingu skualifikoi ditën e djeshme nga radhët e sistemit të drejtësisë, prokuroren në Prokurorinë e Përgjithshme, Rovena Gashi. Vendimi për shkarkimin e saj u mor pas një hetimi administrativ disa mujor dhe zhvillimit të seancës dëgjimore publike. Pas vlerësimit të tri shtyllat e vetingut, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vendosi t'i ndërprejë karrierën prokurores, me arsyetimin se ajo nuk justifikon pasurinë. Seanca u zhvillua në mungesë të Gashi dhe përfaqësuesit të saj ligjor. Më herët gjatë seancës dëgjimore përmes një shkresë drejtuar KPK, Rovena Gashi shprehej se ka refuzuar seancën, pasi vendimin KPK e ka marrë 8 muaj më parë. Rovena Gashi thotë se është intimiduar dhe rendit edhe shkeljet që sipas saj janë bërë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. "Duke qenë se pa një proces të drejtë, nuk mund të ketë kursesi një vendimmarrje të drejtë, subjekti i rivlerësimit, Rovena Gashi, kërkon rikonfirmimin në detyrë, si Prokurore në Prokurorinë e Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë", thuhet ndër të tjera në shkresë e Rovena Gashi. Kujtojmë se Rovena Gashi është e pezulluar nga detyra për shkak se është nën hetim për fshehje pasurie. Trupa gjyqese e KPK përbëhet nga Genta Tafa, Pamela Qirko dhe Luzlim Hamitaj. Ata vendosën shkarkimin e prokurores nga detyra. Rovena Gashi e ka filluar karrierën në prokurori në vitin 2004. Ajo ka punuar si



Prokurore në Prokurorinë e Përgjithshme, Rovena Gashi

KPK

VERIFIKIMI

Sipas KPK Rovena Gashi zotëron një apartament të Shkëmbi i Kavajës me sipërfaqe 105 metra katrorë, i blerë për 80 mijë euro. Rezultoni se ka mospërputhje mes çmimit për blerje të apartamentit, pasi nuk ka deklaruar burime të ligjshme për këtë blerje, që nga pagesa e parë prej 30 mijë eurosh e më pas edhe për burimin prej 50 mijë eurosh.



VERIFIKIMI

prokurore në Tiranë nga vitin 2004 deri në vitin 2013, kur u emërua në krye të Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme. Gashi e mbajti këtë detyrë deri në fund të dhjetorit 2017, kur kryeprokuroreja e re Arta Marku e uli në detyrë. Ndërsa në maj 2018, prokuro-

ria regjistroi procedimin penal ndaj saj dhe bashkëshortit Dritan Gina, të cilët po hetohen për pasurinë e tyre, ndërkohë që Marku i pezulloi të dy nga detyra. Çifti i prokurore Gashi-Gina iu drejtuan Kolegjit të Posaçëm të Apelit për të kontestuar vendimin e pezullimit të tyre nga kryeprokuroreja e

përkohshme, Marku, por kjo kërkesë u rrëzua nga Kolegji. Gashi u bë pjesë e listës prioritare të vetingut përpara telasheve me pasurinë, për shkak të kandidimit të saj për Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe për Gjykatën e Lartë.

PASURIA

Sipas raportit të ILDKPKI, Rovena Gashi nuk justifikonte pasurinë, nuk ka burime të ligjshme si dhe ka bërë deklaram të pasaktë. KPK ka ngritur dyshime për 11 apartamente në Durrës, të cilat dyshohet se i përkasin Nuredin Gashit, babait të Rovena Gashit, të paktën sipas faturave të OSHEE, ndërsa prokurorja pretendon se babai i saj është administrator i pallatit. Gjithashtu, KPK kreu hetim të thelluar për pasurinë e subjektit Gashi që konsiston se Rovena Gashi zotëron një apartament të Shkëmbi i Kavajës me sipërfaqe 105 metra katrorë, i

KARRIERA

Rovena Gashi ka punuar si prokurore në Tiranë nga viti 2004 deri në vitin 2013, kur u emërua në krye të Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme. Ndërsa në maj 2018, prokuroria regjistroi procedimin penal ndaj saj dhe bashkëshortit Dritan Gina, të cilët po hetohen për pasurinë e tyre, ndërkohë që Marku i pezulloi të dy nga detyra.

REFUZIMI

Gjatë seancës dëgjimore përmes një shkresë drejtuar KPK, Rovena Gashi shprehej se ka refuzuar seancën, pasi vendimin KPK e ka marrë 8 muaj më parë. Rovena Gashi thotë se është intimiduar dhe rendit edhe shkeljet që sipas saj janë bërë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

blerë në bashkëpronësi nga bashkëshortët Rovena Gashi e Dritan Gina, për 80 mijë euro. Në deklaratën e kontratës thuhet se do të paguhej në dy këste. Kësti i parë prej 30 mijë euro është paguar paraprakisht. Ndërsa kësti prej 50 mijë eurosh do të paguhej brenda vitit 2011 përmes një transferte bankare. Për sa i përket burimit financiar, shuma prej 45 mijë eurosh është marrë me kredi. Ndërsa shuma prej 35 mijë eurosh është dhënë me çmim preferencial nga Oliver Fucina, përfaqësues e ortak i kompanisë ndërtesuese dhe kunat i prokurores. Ai e ka ulur çmimin duke falur 35 mijë euro. Po kështu rezultoi se ka mospërputhje mes çmimit për blerje të apartamentit, nuk ka deklaruar burime të ligjshme për këtë blerje, që nga pagesa e parë prej 30 mijë eurosh e më pas edhe për burimin prej 50 mijë eurosh.

Sipas KPK-së, janë bërë deklaram të pasakta, janë kryer akte fiktive noteriale dhe janë dhënë përgjigje të pasakta për pyetjet e KPK-së. Gjithashtu, ka një apartament 121 metra katrorë në rrugën "Qemal Stafa" në Tiranë. Prokurorja deklaroi se banesën ia ka dhuruar atij, Nuredin Gashi. Apartamenti është regjistruar më 20 nëntor 2013. Në 2 janar 2018 është konfirmuar për KPK-në se kjo pasuri është në emër të bashkëshortëve. Në kontratë është caktuar shuma prej 38 mijë e 800 dollar, por rezultoi se deklarata e dhurimit e bërë nga babai i prokurores nuk përmban element të formalë. Përveç kësaj, apartamenti në fjalë nuk është deklaruar asnjëherë si pasuri nga Rovena Gashi, ndërsa babai i saj, në vitin 2004 nuk ka pasur burime financiare për blerjen e apartamentit prej 38 mijë dollarësh që më pas ia ka dhuruar së bijës prokurore.

Astrit Faqolli kalon vetingun, KPK: Gjyqtari justifikon pasurinë

Gjyqtari i Gjykatës së Lartë, Ardian Dvorani rikonfirmohet në detyrë, PD: Shërbëtor i Ramës



Gjyqtari i Gjykatës së Lartë, Ardian Dvorani

ARDIAN DVORANI

"Gjykata e Lartë është në vështirësi objektive, pasi numri i gjyqtarëve nuk ka qenë i plotë, në vitin e fundit është i përgjysmuar, pasi disa nga kolegët janë të pezulluar dhe numri është i kufizuar. Ne po bëjmë të pamundurën për të përballur ngarkesën. Detyra jonë është që të gjykojmë çështjet emergjente, të zgjidhim ato që mund të zgjidhim", -u shpreh Ardian Dvorani.

se Dvorani ka burime të mjaftueshme financiare, për të justifikuar të gjitha pasuritë, për të cilat ka bërë deklaram të sakta. Në pasurinë e Dvoranit, numërohet një apartament me sipërfaqe 120 m² në pronësi të dy bashkëshortëve dhe dy apartamente të privatizuar më 1993 dhe 1995 me sipërfaqe

respektivisht 108 m² dhe 76.8 m² dhe një makinë Skoda Otavia, blerë më 2016. Sa i përket figurës morale, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, ka deklaruar se Ardian Dvorani është i përshtatshëm për vijimin e detyrës. Pas rikonfirmimit në detyrë Dvorani përmes një deklarate për

mediat i bëri thirrje kolegëve, që të jenë të pranishëm përballë KPK në seancë, pavarësisht vendimit që mund të merret. Më pas Dvorani foli edhe për situatën alarmante në të cilën ndodhet Gjykata e Lartë, për shkak të reduktimit ndjeshëm të numrit, pasi ky institucion ka mbetur vetëm me 6 anëtarë. "Gjykata e Lartë është në vështirësi objektive, pasi numri i gjyqtarëve nuk ka qenë i plotë, në vitin e fundit është i përgjysmuar dhe në këto momente, pasi disa nga kolegët janë të pezulluar dhe numri është i kufizuar. Ne po bëjmë të pamundurën për të përballur ngarkesën. Por situata është alarmante,

zgjidhjet nuk mund t'i japë Gjykata e Lartë, pasi nuk e plotëson ajo numrin e gjyqtarëve. Detyra jonë është që të gjykojmë çështjet emergjente, të zgjidhim ato që mund të zgjidhim", u shpreh gjyqtari i Gjykatës së Lartë Ardian Dvorani. Në lidhje me këtë vendim ka reaguar përmes një deklarate për mediat nënkryetari i grupit parlamentar të PD, Enkelejd Alibeaj. Alibeaj tha se PD e konsideron farsë procesin dhe lajm të keq për

reformën në drejtësi konfirmimin në detyrë të gjyqtarit që sipas tij nuk justifikon 100 milionë lekë dhe është shërbëtor i kryeministrit Rama. Gjithashtu, ditën e djeshme KPK konfirmoi në detyrë gjyqtarin e Gjykatës së Tiranës, Astrit Faqolli. Mbeshtetur tek raportit i ILDKPKI-së, KPK pohon se Faqolli ka bërë deklaram të saktë të pasurisë, burimet janë të justifikuar dhe nuk ka deklarim të rremë apo fshehje.

Gjyqtari i Gjykatës së Lartë, Ardian Dvorani është rikonfirmuar ditën e djeshme në detyrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) duke vijuar kështu rrugëtimin e tij në sistemin e drejtësisë. Në seancën dëgjimore KPK deklaroi se sipas ILDKPKI gjykatësi ka kryer fshehje pasurie, por nga hetimi administrativ, është provuar se llogaritë bankare në emër të tij, bashkëshortes dhe personave të tjerë të bashkëlidhur, janë deklaruar ndër vite, por jo në deklaratën veting. Komisioni u shpreh se ILDKPKI përpara se të hartonte raportin duhet ta thërriste subjektin dhe ta pyeste për mosdeklarimin e likuiditeteve në shumën e 9.9 mln lekëve, për sa kohë gjyqtari i lartë është shprehur se ishte harrës për shkak të punës. Gjithashtu, nga hetimi është provuar

Nëna e Emiljano Grembit: Djalin ma mori në qafë mbesa, armën e kishte ajo

Grabitësja "sexy": Jam penduar, paratë më duheshin për të rritur 2 fëmijët

Gjykata e lë në burg bashkë me kushëririn, 31-vjeçarja nxjerr gishtin e mesit para mediave

Ervis Kuçi

FIER

Anna Malaj, e cila aku zohet për grabitjen e një pike karburanti në Levan më 2 korrik të këtij viti dhe për tentativë grabitje të dy karburanteve të tjera në Fier dhe Mallakastër dhe ka kërkuar falje në sallën e gjyqit. 31-vjeçarja "sexy", e cila ishte kthyer në tmerrin e karburanteve ka deklaruar se është penduar për atë që ka bërë në bashkëpunim me kushëririn e saj 22-vjeçar, Emiljano Grembin. Ajo është shprehur se paratë i duheshin për të rritur dy fëmijët e mitur, pasi nuk janë mirë ekonomikisht. Pavarësisht pendesës së saj dhe kushëririt, Gjykata e Shkallës së Parë e Fierit ka vendosur ndaj tyre masën e sigurisë "Arrest me burg". Pas daljes nga seanca gjyqësore, Anna Malaj ka bërë një gjest fytes para mediave duke treguar gishtin e mesit. Ndërkaq, në lidhje me ngjarjen ka reaguar nëna e Emiljano Grembit, e cila ka mohuar përfshirjen e të birit në grabitjen me armë të karburantit në Levan të Fierit. "Djali im është i pafajshëm. Atë e ka marrë më qafë mbesa ime", tha Fetië Grembi për "Gazeta Shqiptare".

REAGIMI I NËNËS SË 22-VJEÇARIT
Ndërsa pritej të jepej masa e sigurisë për 31-vjeçaren nga fshati Visokë e Mallakastër, Anna Malaj dhe bashkëpunëtorin e saj, Emiljano Grembi, i cili është djali i hallës, nëna e këtij të fundit mohoi përfshirjen e djalit në grabitje. "Emiljano nuk ka gisht në grabitje. Ai është i pafajshëm. I gjithë fajti është i mbesës sime", u shpreh Fetië Grembi. Gjith-



I arrestuari Emiljano Grembi

31-vjeçarja Anna Malaj



Nëna e 22-vjeçarit, Fetië Grembi



ashtu, nëna e të riuut që u arrestua tri ditë më parë pohoi se është në gjendje të vështirë ekonomike dhe se armën e gahut, me të cilën është grabitur karburanti e kishite mbesa e saj, Anna. "Çunin ma mori në qafë kjo mua.

Hallë më tha, dua çunin se kam frikë, pasi jam vetëm ajo. Anna ka dy fëmijë, një vajzë dhe një djalë, ndërsa burrin e ka në Gjermani. Unë djalin e kisha të rregullt. Djali nuk ka asgjë, as

DËSHMIA E ANNËS PARA HETUESVE
"Gjithçka nisi si aventurë, por ishte dhe hakmarrje. Grabitjen e parë e kryem në gjendje të dehur, pasi festova ditëlindjen. Bashkë me kushëririn tim, Emiljanon shkuam te pika e karburantit në fshatin Levan, pasi disa kohë më parë, punonjësi i këtij karburanti ka gabuar me kursin e këmbimit. Edhe pse debatova me të, punonjësi nuk më ktheu reston e duhur, ndaj dhe u hakmora ndaj tij". Kështu ka deklaruar para hetuesve të çështjes, 31-vjeçarja Anna Malaj, e cila u arrestua, pasi akuzohet se në bashkëpunim me kushëririn 22-vjeçar (djalin e hallës) kanë grabitur një pikë karburanti dhe kanë tentuar që të grabisin dhe dy të tjerë.

shtëpi as pasuri, asgjë. Unë nuk kam as të paguaj. Jam në borxhe. E kam çupë vël-lai atë. E kam nxjerrë dy herë nga shtëpia, pasi e dija se çfarë bënte ajo. I kam thënë burrit, mos ma qas më bren-

da. Djali im s'ka as armë, asgjë. Armën e kishte mbesa me leje. Tim bir e ka marrë ajo se gjoja kishte frikë. Unë isha tek nëna ime se i bëja shërbim. Nuk kam kokërr leku dhe nuk e di se çfarë do të bëhet", tha Fetië Grembi.

SHKURT

U aksidentua me makinën e policisë, vdes efektivi i Rrugores

BERAT - Ka ndërruar jetë në spital efektivi i Rrugores në Berat Myslym Bakëri, 10 ditë pas aksidentit. Makina e policisë, me të cilën udhëtonte efektivi Myslym Bakëri me një koleg të tij u përplas me një mjet tjetër tip "Volsvagen" në aksin Urë Vajgurore-Kuçovë. Pas përplasjes, të dyja mjetet dolën jashtë rrugë dhe përfunduan në një kanal. Efektivi Bakëri u dërgua në Spitalin e Traumës në Tiranë, ku mëngjesin e djeshëm ndërroi jetë. Në aksidentin në fjalë mbeti i plagosur edhe kolegu i tij si dhe drejtuesi i mjetit tip "Volsvagen", me iniciale E.Sh. Funkioni efektivi që ndërroi jetë në krye të detyrës në policinë e shtetit ishte: "Trup shërbimi në sektorin e qarkullimit rrugor" të Policisë Rrugore në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Berat.

Shërr, 4 nipërit në

Roskovec, bëjnë për

spital xhaxhain 55-vjeçar

FIER - Katër nipër janë bërë bashkë dhe kanë dhunuar xhaxhain e tyre 55-vjeçar, me iniciale Xh.M. Ngjarja ka ndodhur ditë më parë në Roskovec të Fierit. Fillimisht ka nisur një sherr mes tyre, që më pas ka degjeneruar në përdorimin e dhunës. "Më datë 24.07.2018, u referuan materialet në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, për shtetasit A.M., E.M., V.M., dhe L.M., vjeç 42, 26, 22 e 21, banues në fshatin Vlosh, Roskovec, pasi dyshohet se kanë ushtruar dhunë fizike ndaj xhaxhait të tyre, shtetasit Xh.M., 55-vjeç thuhet në njoftimin e policisë. Ndërsa, ende nuk dihen motivet që kanë çuar në këtë sherr, që pasoi me dhunën e katër të rinjve ndaj xhaxhait të tyre. Sakaq, policia po punon për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes.

I gjendet kokainë në palestër, bie në pranga 43-vjeçari

BERAT - Një 43-vjeçar është arrestuar nga policia e Beratit, pasi në ambientet e palestërës së tij është gjetur një sasi e vogël kokaine dhe një peshore elektrike. Në pranga është vënë shtetasi Armando Lajthia, banues në lagjen "30 Vjetori" të këtij qyteti. Sipas policisë, arrestimi i tij u bë menjëherë pasi kontrollit të ushtruar në ambientet e palestërës së tij. Materialet në ngarkim të 43-vjeçarit i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike".

Ngjarja në 2017-ën, çështja kalon te Krimet e Rënda

Vrau nipin me thikë për oborrin, gjykata e Shkodrës shpall moskompetencë për dosjen

SHKODËR - Gjykata e Shkallës së Parë e Shkodrës ka dërguar për kompetencë në Gjykatën e Krimet e Rënda në Tiranë, çështjen e Mirsad Kuçit, i cili u vra nga xhaxhai i tij, Bujar Kuçi për shkak të mosmarrëveshjeve mes tyre për oborrin. Ngjarja ndodhi në Shkodër më 23 shtator të 2017-ës, në një rrugicë pas teatrit "Migjeni". Pas asaj ngjarje, gjykata la në "arrest me burg" autorin e dyshuar, i cili fillimisht u dërgua te Krimet e Rënda, gjykatë, e cila e riktheu edhe njëherë këtë çështje tek shkalla e parë në Shkodër. Gjatë seancës paraprake, para dërgimit të çështjes në gjyq u përballën babai i vik-

KONFLIKTI

Shkak për këtë ngjarje të rëndë, sipas burimeve nga dëshmitarët që kanë dëgjuar atë që ka ndodhur është bërë oborri i përbashkët mes tyre. Një prej debateve ka qenë zënia e oborrit me makinë nga 33-vjeçari. Më pas ditën e ngjarjes xhaxhai i është ankuar nipit të tij për jashtëqitjen e qenit duke i thënë se "përse vjen nga pjesa ime qeni jot".

timës, Faik Kuçi me vëllanë e tij të akuzuar, Bujar Kuçi. Sapo ka nisur seanca gjyqësore, babai i viktimës doli nga sallja e gjyqit duke mos arritur ta përballojë. Ai tha përpara trupit gjyqes fjalët: Ju bëni çfarë të doni, mua më ka ikur djali dhe më ka lënë dy jetimë. Pas këtyre fjalëve,

Faik Kuçi ka tentuar të shkojë drejt xhamit ku ndodhej vëllai i tij i dyshuar për vrasjen e Mirsad Kuçit. Në ato momente babai i viktimës ka dalë jashtë sallës duke mos e përballuar me emocionalisht për shkak se vuan nga zemra. Nga ana tjetër autori i dyshuar, Bujar Kuçi ka pran-



Viktima Mirsad Kuçi

uar krimin e kryer, por është shprehur përpara gjykatës se e ka vrarë nipin, pasi ky i fundit ka tentuar ta vrasë atë në gjendje të dehur. Bujar Kuçi deklaroi se e ka qëlluar me thikë nipin 33-vjeçar, për t'u vetëmbrojtur nga ai. Në fund, togat e zezë të Shkodrës e dërguan këtë çështje për kompetencë te Krimet e Rënda. Ngjarja e rëndë ndodhi pasditën e 23 shtatorit të vitit që shkoi, në një banesë pas teatrit "Migjeni". Bujar Kuçi 62 vjeç goditi për vdekje vrarë nipin,

Mirsad Kuçi 33 vjeç. Në momentin e krimit, viktimja ka qenë në kuzhinën e xhaxhait, kur papritur ky i fundit i është afruar me një thikë në dorë dhe ka nisur që ta godasë në trup. Viktimja mori tri plagë, një në këmbë, një në bark dhe goditja fatale ka qenë thika në zemër. Familja e autorit Bujar Kuçi dhe viktimës jetonin brenda një oborri pa mur ndarës, por në shtëpi të ndryshme. Mësohet se krimi ka ndodhur pas mosmarrëveshjeve mes tyre për oborrin.

Neritan Kalamishi: Ju bëfshin ilaçe kush ka vjedhur edhe një lekë nga buxheti i klubit

Senad Nikshiqi

SHKODËR

Skandali me fondet te Vllaznia, ish-administratori: Sulm politik, akuzat ndaj nesh janë qesharake

"Auditi i KLSH-së u porosit nga Doshi e Sterkaj. Me 28 mln lekë nuk mund bësh abuzim dhe po të duash"

Ish-administratori i klubit të futbollit "Vllaznia" sh.a, Neritan Kalamishi, i cili është marrë i pandehur, i quan sulm politik dhe qesharak akuzat që ka ngritur ndaj tij prokuroria e Shkodrës për shpërdorim të fondeve publike dhe shkelje të barazisë së pjesëmarrësve në tender. Një ditë pasi dosja ndaj dy ish-administratoreve dhe financierit të klubit në fjalë u dërgua për gjykim, ka reaguar ashpër Kalamishi. Ai deklaroi dje për "Gazeta Shqiptare" se nuk i pranon akuzat, ndërsa i cilëson si të sajuar nga banda kriminale e qeverisë aktuale. "Gjithçka është politike. Fatos Gjyzezi ish-prefekt i PD-së, unë ish-komisioner i PD-së, Denis Fani ish-kandidat i PD-së për deputet. Me 28 milionë lekë të reja të ardhura nuk mund të bësh shpërdorim edhe po të duash. Kontratat e shërbimit nuk mund të hidhen në tender kur nuk ke fond të miratuar, por bëhen blerje të vogla, aq sa ke lekë në arkë. Është shumë qesharake edhe ai auditi i KLSH-së i porositur nga Paulin Sterkaj e Tom Doshi! Po të bëhej tender pa pasur fondin e miratuar është shkelje penale, po ku marrin vesh nga ligji militantët e PS-së. Prandaj unë edhe kam prishur kontratat edhe me trajnerët Baldo Ranieri dhe të tjerët dhe duke vendosur trajner nga akademia, pikërisht se Këshilli Bashkiak nuk miratonte fondet dhe kur nuk ke lekë, mund të biesh nga kategoria", tha Neritan Kalamishi.

300

MLN LEKË Prokuroria e Shkodrës mori të pandehur dhe dërgoi për gjykim ish-administratoret e klubit të futbollit "Vllaznia" sh.a dhe financierin e këtij klubi. Për ta u ngritën akuzat për shpërdorim detyre, shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tender dhe shpërdorim i fondeve publike, duke i shkakuar shtetit një dëm ekonomik prej afro 30.000.000 lekësh.



Ish-administratori i klubit të futbollit "Vllaznia", Neritan Kalamishi



Fatos Gjyzezi dhe drejtues të tjerë të Vllaznisë

Akuza e Kalamishit: Bashkia ka humbur miliona lekë të taksapagueseve, iu dorëzuan qeverisë 'Rama'

SHKODËR - Neritan Kalamishi nuk ka akuzat vetëm për qeverinë, por edhe vetë kryetaren e bashkisë Shkodër, Voltana Ademi: "Vetëm nga ndryshimi i kontratave nga ato të shërbimit në kontrata pune, bashkia Shkodër ka humbur miliona lekë të taksapagueseve shkodran dhe i janë dorëzuar qeverisë së Edi Ramës. Ky është shpë-



rdorim. Futbollistët nuk mund të kenë kontrata pune, pasi ato dalin vetëm 12 orë punë (shërbim në

javë dhe jo 40 orë), katër ditë nga dy orë shtëviti dhe katër orë ditën e ndeshjes". Prokuroria e Shkodrës akuzon për shkelje dhe shpërdorim detyre ish-administratoret e Vllaznisë; Fatos Gjyzezi dhe Neritan Kalamishi si dhe ish-financierin, Denis Fani duke pretenduar se kanë shkakuar një dëm ekonomik në shtet prej 300 milionë lekë të vjetër.

DEKLARATA "Me 28 milionë lekë të reja të ardhura nuk mund të bësh shpërdorim edhe po të duash. Kontratat e shërbimit nuk mund të hidhen në tender kur nuk ke fond të miratuar, por bëhen blerje të vogla, aq sa ke lekë në arkë. Është shumë qesharake edhe ai auditi i KLSH-së i porositur nga Paulin Sterkaj e Tom Doshi! Po të bëhej tender pa patur fondin e miratuar është shkelje penale, po ku marrin vesh nga ligji militantët e PS-së", deklaroi dje për "GSH", Neritan Kalamishi

Tentoi t'i bente atentat 29-vjeçarit, në kërkim agresori

LUSHNJË - Një atentat me armë zjarri ka ndodhur dy ditë më parë në qytetin e Lushnjës. Dyshohet se shtetasi me iniciale S.Xh., 26 vjeç ka tentuar të vrasë me pistoletë bashkëqytetarin e tij, shtetasin A.Ç., 29 vjeç. Mësohet se në momentin e ngjarjes, ky i fundit ishte duke lëvizur me automjetin e tij tip "Peugeot", dhe fatmirësisht u ka shpëtuar plumbave. Në pranga është vënë shtetasi Ilirjan Xhelu, 60 vjeç, babai i atentatorit të dyshuar, pasi akuzohet se e ka ndihmuar atë të largohet nga vendngjarja pas të shtënavës. Në datën 24.07.2018 u referuan materialet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë për shtetasin S.Xh., banues në Lushnjë, pasi dyshohet se ka tentuar të vrasë me armë zjarri pistoletë shtetasin A.Ç., 29 vjeç, banues në Lushnjë, i cili po udhëton me automjetin e tij tip "Peugeot". Gjithashtu, u arrestua në flagrancë shtetasi I.Xh., 60 vjeç, banues në Lushnjë, pasi dyshohet se ka ndihmuar autorin të largohet. Po punohet për kapjen e autorit të dyshuar dhe zbardhjen e plotë të ngjarjes", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë.

nga mediat dhe të gjithë dokumentacionin e kanë marrë vetë si u ka dashur qejfi. Me siguri ato mundohen që të pengojnë kthimin tim një ditë, por gabohen" - u shpreh ish-administratori i klubit të futbollit "Vllaznia". Ndërkohë, Kalamishi sqaroi duke thënë se edhe në kohën e tij kanë dashur ta hedhin Vllazninë nga kategoria dhe se ai nuk e ka lejuar një gjë të tillë: "Me 28 milionë lekë të reja përshihen të gjithë rrogat e lojtarëve, trajnerëve, shërbimi me autobus, hotelet, ushqimi e çdo shërbim tjetër. Ato janë munduar ta hedhin Vllazninë nga kategoria në dorën

time, por veç Zoti e di si e kam mbajtur pa rënë. Po ju sqaroj se nga muaji maj kur isha unë, Lorenç Luka nuk kishte të drejtë firme dhe Voltana Ademi e merre atë në shtator kur merkatotja mbyllej në gusht dhe po në gusht fillonte kampionati. Arka e klubit kishte zero lekë. Qesharake si mund të bësh tender pa lekë". Ish-administratori hedh poshtë pretendimet se ka bërë shkelje në kohën kur drejtonte Vllazninë: "Ju garantoj se e njoh ligjin më mirë se ato që flasin tërë ditën vetëm një fjalë 'ligji'. Për sa i përket federimit janë federuar 28 tek Vllaznia dhe

të tjerët tek Vllaznia B. Ekzakt sipas ligjit. Sqaroj këtu se kam krijuar Vllazninë B sipas një vendimi të Këshillit Bashkiak të mëparshëm duke ruajtur numrin e lojtarëve 18 vjeç që i duheshin ekipit të parë dhe duke mos djegur lojtarët e akademisë dhe të marrin nga federata ligjshmërinë. Edhe po të dua unë të federohem nga federata, nuk ferohej nga federata. Të gjitha kontratat janë lidhur pas tri ofertash, ashtu siç thotë ligji. Por të nxjerrin edhe vlerat që kemi paguar, të gjitha nën vlerën e tregut. Për hotelet të nxjerrin edhe faturat dhe kur luan V-

lazia në Vlorë nuk mund t'i çojmë për të fjetur tek hoteli morri në Librazhd se është më lirë. T'ia kërkojnë bashkisë se sa është vlera që kanë paguar ata për hotelet për një sezon, dhe sa ka qenë e jona dhe ju garantoj se këto mund ta kenë dyfishin. Ne e kemi çuar ekipin të luaj brenda ditës në Pukë dhe në Ballsh, pikërisht se nuk kishim lekë". Duke dashur të tregojë pastërtinë e tij ish-administratori Neritan Kalamishi ka edhe një mesazh: "Po e mbyll me një shprehje popullore: Ju bëfshin ilaçe çdo njërit që ka vjedhur edhe një lek nga buxheti i Vllaznisë".

SHPLLJE ANKANDI Datë 31.07.2018, Ora 16:00 Shoqëria Përmbarrimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.

SHPLLJE ANKANDI Datë 01.08.2018, Ora 16:30 Shoqëria Përmbarrimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.

SHPLLJE ANKANDI Datë 01.08.2018, Ora 16:00 Shoqëria Përmbarrimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.

Zgjerohet harta e bashkëpunimit me ndërkombëtarët, mundësi më shumë për studentët

"Luarasi", marrëveshje me universitetin e Barit në Itali

Rektori Uriçi: Luarasi, ndër më cilësorët në Shqipëri

Voltiza Duro

Kolegji Universitar "Luarasi", një ndër institucionet më prestigjioze të arsimit të lartë në vend ka nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit me një universitet të rëndësishëm në Itali. Kështu, viti i ri akademik 2018-2019 do të ofrojë më tepër mundësi për studentët, e projekte ambicioze që pritet të realizohen në bashkëpunim me universitetin e Barit "Aldo Moro". Ky i fundit me 50 mijë studente dhe mbi 2000 pedagogë është një ndër partneret më të ri të Luarasit. Marrëveshja u firmos nga Rektori i Luarasit, Prof. Et'hem Ruka dhe Rektori i Universitetit Aldo Moro, Prof. Dr. Antonio Felice Uriçi. Rektori i Luarasit, profesor Et'hem Ruka, duke u ndalur në karakterin ndërkombëtar të universitetit ftoi stafin pedagogjik të universitetit të Barit të ndajnë dijet dhe eksperiencën e tyre në auditorët e Luarasit. "Personalisht unë dhe kolegët e mi e vlerësojmë jashtëzakonisht shumë marrëdhënien me Universitetin e Barit. Sado modeste të jetë kjo marrëveshje, ajo forcon urrën që lidh të dyja anët e Adriatikut, Shqipërinë edhe Italinë në fushën e arsimit të lartë. Uroj që kjo marrëveshje nuk do të mbetet thjesht një e tillë, por do mundohemi t'i japim jetë për të forcur marrëdhëniet mes nesh për shkëmbim studentësh, për informacione më



Rektori i Luarasit, Prof. Et'hem Ruka dhe Rektori i Universitetit Aldo Moro, Prof. Dr. Antonio Felice Uriçi, gjatë firmosjes së marrëveshjes

të pasura në fushën e kurrikulave të cilat ne kemi nevojë", tha Ruka në fjalën e tij. Ndërkohë rektori i universitetit të Barit Antonio Uriçi e vlerëson "Luarasin" si një ndër universitetet më cilësore të Shqipërisë. Ai tha se firmosja e kësaj marrëveshjeje mes dy universiteteve, është një moment i rëndësishëm në

drejtim të konkretizimit të bashkëpunimit për projekte ambicioze, që do të realizohen duke nisur që ketë vit të ri akademik. "Jam i sigurt që cilësia e këtij universiteti është shumë e mirë. Jam i sigurt që dhe kualiteti i stafit akademik është i shkëlqyer "Luarasi" është një mundësi. Ne kemi fusha të përbash-

këta si drejtësia, teknologjia e informacionit. Ne sapo nënshkruam një marrëveshje për të bashkëpunuar pikërisht në këto fusha që përmenda", -u shpreh rektori italian Antonio Felice Uriçi. Më tej ky i fundit shtoi se universiteti i Barit, është një nga universitetet me të vjetër në Itali, e mban emrin e Aldo

VLERËSIMI

"Jam i sigurt që cilësia e këtij universiteti është shumë e mirë. Jam i sigurt që dhe kualiteti i stafit akademik është i shkëlqyer "Luarasi" është një mundësi. Ne kemi fusha të përbashkëta si drejtësia, teknologjia e informacionit. Ne sapo nënshkruam një marrëveshje për të bashkëpunuar pikërisht në këto fusha që përmenda", -u shpreh rektori italian Antonio Felice Uriçi.

shpreso që shumë shpejt të jetë pjesë e Bashkimit Europian. Falënderoj profesor Rukën për këtë mundësi që na dha për të bashkëpunuar. Unë e kam njohur personalisht kur ishte ministër i Arsimit e di që në krye të Luarasit do të japi jetë marrëveshjes sonë", theksoi më tej Uriçi. "Luarasi" dhe Universiteti i Barit Aldo Moro kanë rënë dakord për të shkëmbyer studentët dhe stafin akademik. Ndërkohë dy institucionet e arsimit të lartë do të organizojnë edhe konferenca shkencore dhe seminare akademike si dhe do të bashkëpunojnë për realizimin e projekteve ndërkombëtare të financuara nga Bashkimi Europian. Kolegji Universitar "Luarasi" i kushton një rëndësi të veçantë bashkëpunimit me universitetet prestigjioze europiane e më gjerë, duke synuar kështu zgjerimin e hartës së bashkëpunimit me sa më shumë universitete. Këto marrëveshje ndërkombëtare kanë si qëllim kryesor rritjen e mundësive për stafin dhe për studentët që marrin dije në këtë institucion elitare të arsimit të lartë.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT MË VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID



KËSHILLI BASHKIAK PROPOZIMET

Voltiza Duro

Ditën e sotme do të mbahet mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak të Tiranës, ku priten të miratohen një sërë vendimesh me karakter social në ndihmë të kategorive në nevojë. Respektivisht do të bëhet shqyrtimi për projektvendimin për dhënie e ndihmës ekonomike për rreth 3200 familje në kryeqytet; si dhe për projektvendimin për miratimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe invaliditet e punës. Në mbledhje priten, gjithashtu, miratimi i projektvendimit "Për miratimin e familjeve aplikuese që përfitojnë nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6%, nga fondi i kush-tëzuar dhe nga buxheti i Bashkisë Tiranë, për periudhën 1-30 qershor 2018". 'Gazeta Shqiptare' publikon sot tabelën përmblidhëse të njësive administrative për përdorimin e fondit të kush-tëzuar deri në 6% për muajin qershor të këtij viti, bazuar në numrin e familjeve përfituese dhe sasisë së parave që iu takojnë. Sipas relacionit të Këshillit Bashkiak të Tiranës, pranë Drejtorisë së Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale janë depozituar në total 380 dosje, e nga këto 119 do të trajtohen me fonde të buxhetit vendor, ndërsa 261 prej tyre nga fondi i kush-tëzuar 6%. "Struktura përgjegjëse propozon që të trajtohen familjet që kanë në përbërje të tyre: familje me më shumë se 4 anëtarë në nevojë, familje me një anëtar në nevojë; familje nga 2-4 anëtarë në nevojë; familje rome dhe egjiptiane; vajza-nëna në nevojë; gratë kryefamiljare të divorcuara/ të veja me fëmijë në ngarkim; familje me 2 anëtarë në vështirësi për t'u pranuar në tregun e punës", - theksohet në relacion.

KOMPENSIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE

Ndërkohë, gjatë mbledhjes së sotme të Këshillit Bashkiak të Tiranës priten miratimi i kompensimit të çmimit të energjisë elektrike për kategoritë përfituese për periudhën 1-30 qershor 2018. 'Gazeta Shqiptare' zbardh sot përmblidhjen e bordrosë së kompensimit të energjisë për ndihmën ekonomike për përfituesit gjatë periudhës së sipërpërmendur. Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave individët përfitues të statusit të invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik si dhe të verbër që kanë nevojë për

Mbledhja e Këshillit Bashkiak të Tiranës/ Shqyrtim i vendimeve me karakter social

Projektvendimi: Ndhmë ekonomike deri në 6% për familjet në nevojë

Kompensim i faturave të energjisë, kategoritë përfituese



Gjatë një mbledhjeje të Këshillit Bashkiak të Tiranës

Permbledhje e bordrosë së kompensimit të energjisë për ndihmën ekonomike per periudhën muaji Qershor 2018

| Nr | Njesia | NR | KOMPENSIMI | NR | HEQJA E FASHES | TOTALI |
|---------------|--------------------|------------|----------------|------------|----------------|----------------|
| 1 | Njesia 1 | 2 | 1,280 | - | - | 1,280 |
| 2 | Njesia 2 | 15 | 9,600 | 15 | 9,720 | 19,320 |
| 3 | Njesia 3 | 3 | 1,920 | 3 | 1,944 | 3,864 |
| 4 | Njesia 4 | 5 | 3,200 | 5 | 3,240 | 6,440 |
| 5 | Njesia 5 | 11 | 7,040 | 11 | 7,128 | 14,168 |
| 6 | Njesia 6 | 20 | 12,800 | 15 | 9,720 | 22,520 |
| 7 | Njesia 7 | 3 | 1,920 | 2 | 1,296 | 3,216 |
| 8 | Njesia 8 | 8 | 5,120 | 8 | 5,184 | 10,304 |
| 9 | Njesia 9 | 11 | 7,040 | 11 | 7,128 | 14,168 |
| 10 | Njesia 10 | - | - | - | - | - |
| 11 | Njesia 11 | 23 | 14,720 | 9 | 5,832 | 20,552 |
| 12 | Njesia Petrele | 11 | 7,040 | 11 | 7,128 | 14,168 |
| 13 | Njesia Farke | 34 | 21,760 | 34 | 22,032 | 43,792 |
| 14 | Njesia Dajt | - | - | - | - | - |
| 15 | Njesia Zall-bastar | 107 | 68,480 | 10 | 6,480 | 74,960 |
| 16 | Njesia Berzhite | 90 | 57,600 | 90 | 58,320 | 115,920 |
| 17 | Njesia Krrabe | 25 | 16,000 | 25 | 16,200 | 32,200 |
| 18 | Njesia Baldushk | - | - | - | - | - |
| 19 | Njesia Shengjergj | 23 | 14,720 | 23 | 14,904 | 29,624 |
| 20 | Njesia Vaqarr | 60 | 38,400 | 60 | 38,880 | 77,280 |
| 21 | Njesia Kashar | 23 | 14,720 | 23 | 14,904 | 29,624 |
| 22 | Njesia Peze | 16 | 10,240 | 16 | 10,368 | 20,608 |
| 23 | Njesia Ndroq | 9 | 5,760 | 3 | 1,944 | 7,704 |
| 24 | Njesia Zall-herr | - | - | - | - | - |
| TOTALI | | 499 | 313,600 | 374 | 242,352 | 561,712 |

Konceptoi: Sp. Dh. Polovina Pranoi: Përgj. F.Haxhi Miratoi: Dr/DMPs: M.Kokeri

kujdestar do të marrin kompensimin prej 2 mijë lekësh në muaj. Ndërkohë një kompensim prej 1400 lekësh në muaj do e përfitojnë të gjithë ata persona të verbër, si dhe përfituesit e statusit të invaliditet që nuk kanë nevojë për kujdestar. Ndërkohë theksohet se individët përfitues të statusit të invaliditet dhe të të verbër, që kanë nevojë për kujdestar do të marrin një kompensim prej 1 mijë lekësh në muaj për faturën e telefonisë fikse. Kategoritë që përfitojnë kompensim për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 kwh në muaj janë edhe: familjet që trajtohen me ndi-

hmë ekonomike; kryefamiljarët që përfitojnë pension invaliditeti shtetëror dhe pension invaliditeti të plotë në fshat me anëtarë të punësuar; kryefamiljarë që përfitojnë pension pleqërie shtetëror, pension pleqërie fshati ose pension social. Gjithashtu, edhe familjet e punonjësve buxhetorë me pagë bruto nën 35 mijë lekë në muaj që nuk kanë anëtarë

të tjerë të punësuar apo vetëpunësuar përfitojnë nga ky kompensim i energjisë. Nga ky i fundit parashikohet të përfitojnë edhe të verbër, personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë si dhe kryefamiljarët që përfitojnë pension të plotë pleqërie ose pension social me banim në fshat, kur familja është e përbërë vetëm nga pensionistë.

Shitje me Ankand të Pare nga Studio Permbartimore L.D.C

"Apartment", me sip. 69.2 m2, Nr pasurije 10/158+2-1, të ndodhur në Zonën Kadastrale Nr. 8631, Vol. 9, Faqe 80, me adresë Lagja Skenderbeg, Shk. 2, Kati 1, Ap. 1. Prona është e regjistruar pranë Z.V.R.P Lezhe, në emër të Lutizim Kros Beqiri. Çmimi fillestar për shitje është 3.100.000 Leke.

Data e shpalljes 05.07.2018
Data e zhvillimit 31.07.2018 deri në orën 16.00
 Ankandit zhvillohet në ambientet e Studios Permbartimore L.D.C me adresë Rruga "Myslim Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.

PËRFITUESIT
 "Struktura përgjegjëse propozon që të trajtohen familjet që kanë në përbërje të tyre: familje me më shumë se 4 anëtarë në nevojë, familje me një anëtar në nevojë; familje nga 2-4 anëtarë në nevojë; familje rome dhe egjiptiane; vajza-nëna në nevojë; gratë kryefamiljare të divorcuara/ të veja me fëmijë në ngarkim; familje me 2 anëtarë në vështirësi për t'u pranuar në tregun e punës", - theksohet në relacion.

| Masa e ndihmës ekonomike | | | |
|--------------------------|-----------------------|---------------|----------------|
| Nr | Njesia Administrative | Nr. Familjeve | Lekë |
| 1 | Njesia 1 | 16 | 38,460 |
| 2 | Njesia 2 | 15 | 38,880 |
| 3 | Njesia 3 | 9 | 28,080 |
| 4 | Njesia 4 | 12 | 38,880 |
| 5 | Njesia 5 | 12 | 40,140 |
| 6 | Njesia 6 | 12 | 33,840 |
| 7 | Njesia 7 | 15 | 36,360 |
| 8 | Njesia 8 | 17 | 37,980 |
| 9 | Njesia 9 | 14 | 32,940 |
| 10 | Njesia 10 | 9 | 28,940 |
| 11 | Njesia 11 | 21 | 57,960 |
| 12 | Njesia Petrele | 3 | 9,120 |
| 13 | Njesia Farke | 6 | 21,780 |
| 14 | Njesia Dajt | 8 | 33,300 |
| 15 | Njesia Zall-bastar | 15 | 43,660 |
| 16 | Njesia Berzhite | 8 | 22,680 |
| 17 | Njesia Krrabe | 4 | 15,120 |
| 18 | Njesia Baldushk | 4 | 12,240 |
| 19 | Njesia Shengjergj | 14 | 43,740 |
| 20 | Njesia Vaqarr | 7 | 19,440 |
| 21 | Njesia Kashar | 18 | 43,740 |
| 22 | Njesia Peze | 12 | 24,300 |
| 23 | Njesia Ndroq | 6 | 18,900 |
| 24 | Njesia Zall-herr | 4 | 14,580 |
| TOTALI | | 261 | 735,820 |

| Masa e ndihmës ekonomike | | | |
|--------------------------|-----------------------|---------------|----------------|
| Nr | Njesia Administrative | Nr. Familjeve | Lekë |
| 1 | Njesia 1 | 3 | 9,720 |
| 2 | Njesia 2 | 10 | 19,400 |
| 3 | Njesia 3 | 5 | 13,320 |
| 4 | Njesia 4 | 10 | 18,900 |
| 5 | Njesia 5 | 6 | 19,980 |
| 6 | Njesia 6 | 6 | 19,080 |
| 7 | Njesia 7 | 8 | 17,820 |
| 8 | Njesia 8 | 6 | 19,440 |
| 9 | Njesia 9 | 6 | 13,500 |
| 10 | Njesia 10 | 8 | 18,000 |
| 11 | Njesia 11 | 9 | 19,260 |
| 12 | Njesia Petrele | 2 | 9,060 |
| 13 | Njesia Farke | 4 | 19,080 |
| 14 | Njesia Dajt | 4 | 13,320 |
| 15 | Njesia Zall-bastar | 4 | 13,680 |
| 16 | Njesia Berzhite | 3 | 8,640 |
| 17 | Njesia Krrabe | 3 | 10,620 |
| 18 | Njesia Baldushk | 3 | 9,180 |
| 19 | Njesia Shengjergj | 3 | 9,180 |
| 20 | Njesia Vaqarr | 3 | 9,720 |
| 21 | Njesia Kashar | 3 | 9,720 |
| 22 | Njesia Peze | 2 | 7,320 |
| 23 | Njesia Ndroq | 2 | 7,320 |
| 24 | Njesia Zall-herr | 5 | 14,580 |
| TOTALI | | 119 | 332,240 |

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARTIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

Pasuria nr. 3/438+2-53, LLOJ 'APARTAMENT', VOLUMI 36, FAQE 37, SIPERFAQE 103 M2, ZONAKADA STRALE 8380, TIRANE, NË PRONËSI TË Z. ALBAN QEMAL BALA.

ÇMIMI 12.016.000 LEKË - Data e zhvillimit të ankandit do jetë 08.08.2018.

CEL. 0684026666 ; 0693262866

Shëndetësi

Flavonoidet i japin veti antioksidante bimës, ndërkohë sipas testeve në laborator flavonoidet forcojnë nervat, muskujt e zemrës, rrjedhjen e gjakut, dhe mbrojnë retinën nga dëmtimi. Sakaq, Ginkgo Biloba ndihmon në largimin e radikaleve të lira. Këto të fundit krijohen në trupin tonë gjatë procesit normal të metabolizmit, ose hyjnë në organizëm nëpërmjet burimeve të jashtme si duhanpirja, ndotja e mjedisit ose ekspozimi në diell në orare të zgjatura.



Mjeku popullor: Kujdes gjatë përdorimit, farat përmbajnë helm. Si të përgatisni çajin

Voltiza Duro

Bima Ginkgo Biloba rritet afërsisht 37 metra, dhe jeton deri në 1000 vjet, megjithëse në Kinë ajo mund të arrijë në një vjetërsi 2500 vjeçare. Vendet më të përshatshme për rritjen e kësaj bime janë tokat me lagështirë dhe pyjet. Sipas studimeve nevojiten rreth 20-35 vite që bima të arrijë maturimin dhe të prodhojë frutin. ADN e Ginkgos është studiuar nga një grup biologësh e për ta ruajtur kodin gjenetik i janë nevojitur 10 GB. Pra, është një kod gjenetik më i madh sesa ai i misrit dhe orkidesë, 80 herë më i madh, të cilat janë bimët me gjenomen më të madh të njohur deri më sot. Gjenoma e bimës është kaq e madhe për shkak të dyfishimeve të gjeneve dhe sekuenceve të përsëritura që përmban, 76.85% e AND-së. Kjo bimë përmban rreth 40 mijë gjene.

DOBITË E BIMËS

Flavonoidet i japin veti antioksidante bimës, ndërkohë sipas testeve në laborator flavonoidet forcojnë nervat, muskujt e zemrës, rrjedhjen e gjakut, dhe mbrojnë retinën nga dëmtimi. Sakaq, Ginkgo Biloba ndihmon në largimin e radikaleve të lira. Këto të fundit krijohen në trupin tonë gjatë procesit normal të metabolizmit, ose hyjnë në organizëm nëpërmjet burimeve të jashtme si duhanpirja, ndotja e mjedisit

YLLI MERJA: Efektet kurative të 'bimës së trurit', Ginkgo Biloba

"Rol kyç në përmirësimin e qarkullimit të gjakut"



Mjeku popullor
Ylli Merja

ose ekspozimi në diell në orare të zgjatura. Radikalet e lira qarkullojnë në trupin tonë, duke shkaktuar oksidim, një reaksion kimik që dëmton qelizat dhe materialet gjenetik, AND-në. Ndërsa

terpenoidet përmirësojnë rrjedhjen e gjakut duke zmadhuar enët e gjakut dhe reduktojnë ngjitjen e plateleve. Ginkgo Biloba përdoret gjerësisht për sëmundjet mendore e si pasojë quhet ndryshe edhe si bima e trurit pasi përmirëson rrjedhjen e gjakut në tru, e shërben si antioksidant i fuqishëm për këtë organ duke nxitur largimin e toksinave nga neuronet. Këshillohet të përdoret për sëmundje si Alzheimer, dementia, humbje të kujtesës, apo njerëzit me depression. Kjo bimë ndihmon në kthjellimin e mendimeve, përmirëson procesin e të mësuarit, të menduarit, dhe kujtesën. Kjo bimë çudibërëse e ndihmon trurin të jetë më aktiv pavarësisht vështirësisë së aktivitetit ditore që mund të ushtrrojë një person. Ndërkohë ka veti në përmirësimin e sjell-

provuar në pacientë të ndryshëm dhe pas një trajtimi me Ginkgo Biloba, kombinuar me bimë të tjera kanë treguar shumë përmirësim.

KURIMI I ANKTHIT

Ginkgo Biloba mund të përdoret nga personat me depression apo ankth, por jo në të njëjtën kohë me ilaçe të tjera antidepresive, pasi mund të ndikojë negativisht në veprimin e medikamentit, duke e ndryshuar atë. Gjithashtu, njerëz të cilët vuajnë nga Glaucoma, probleme me shikimin, apo shikimin për shkak të dëmtimit të retinës, këshillohet të përdorin Ginkgo Biloba. Bima ka treguar përmirësim të shikimit tek njerëzit me Glaukoma. Gjithashtu, bima ruan shikimin tek njerëzit që

Ndërkohë Ginkgo Biloba vepron si qetësues i kollës, normalizuese e tensionit, hidratuese që frenon plakjen e trurit, normalizuese dhe nxitëse e veprimit të sistemit nervor, forcuese e kujtesës etj.

VETI TË TJERA

Bima Ginkgo Biloba njihet edhe për disa veti të tjera kurative. Kështu ajo minimizon dhimbjet e varqeve, dhe ndihmon në zvogëlimin e tyre si dhe largon krimbat e zorrëve; ndihmon në trajtimin e Gonhorresë; shërben si anti-alergjik; qetëson kollën; e normalizon tensionin. Me poshtë po shpjegojmë mënyrën sesi ta përdorni bimën e Ginkgo Biloba. Kështu në një gotë me ujë



jeve sociale, duke ndihmuar njerëzit që kanë probleme të jenë të hapur në shoqëri apo në aktivitetet ditore sociale. Gjithashtu, Ginkgo Biloba mund të përdoret tek fëmijët apo adoleshentët që kanë vështirësi në komunikim apo vështirësi në të shprehur. Të gjitha këto veti janë

vuajnë nga sëmundje si Degjenerimi makular i lidhur me moshën (sëmundje që degradon shikimin me kalimin e moshës). Prania e terpenëve, tanineve, flavonoidëve, vitaminës C, karotenoidëve dhe shumë përbërësve të tjerë kimikë i japin bimës veti anti-alergjike.

vloni për 1-2 minuta një lugë gjelle me këtë lloj bime. Çaji i përgatitur duhet të pihet gjatë ditës. Vlen të theksohet se farat përmbajnë një toksinë që quhet Ginkgotoksina, që shkaktonte helmim. Kinezët i përdorin farat si ushqim, por duhen gatuar mirë.



Llogariten sipërfaqet takuese për pronarët, poseduesit marrin tapinë

Ornela Manjani

Qeveria miraton të drejtën mbi pronën për 600 ndërtime

Lista me përfituesit në të gjithë vendin

Këshilli i Ministrave ka miratuar të drejtën për kalimin e pronësisë të parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale. Bëhet fjalë për 600 parcela ndërtimore në të gjithë vendin, kur personat që kanë ndërtuar pa leje do të marrin tapinë mbi truallin. Sipas listës së miratuar nga qeveria dhe të botuar në Fletoren Zyrtare mësohet se është përllogaritur sipërfaqja takuese, ku në pjesën më të madhe të raste ka ndryshime në m² që përfliojnë pronarët. Lista është botuar në Fletoren Zyrtare dhe pronarët e truallit do të marrin certifikatën e

pronësisë mbi tokën ku kanë ndërtuar.

TAPIA

Procedurat për marrjen e tapisë janë ndjekur nga ALUIZNI, i cili dorëzon dosjen e plotë në hipotekë, por përfituesit duhet të shkojnë në Zyrën e Regji-

strimit të Pasurive të aplikojnë për tapinë. Pas ndryshimeve të fundit ligjore, qytetari do të marrë një kopje për të vërtetuar mbarimin e procesin të legalizimit, por e gjithë procedura vijuese për regjistrimin në Zyrën e Regji-

strimit të Pasurive të Palujtshme do të bëhet nga Agjencia. Ndërkohë që sipërfaqja e parcelës, për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqes së bazës së ndërtimit dhe për

ndërtimet pa leje me funksion banimi jo më shumë se 500 m². Sipërfaqet mbi masat e përcaktuara në këtë pikë, të cilat për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, i shiten poseduesit të

ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka shprehur më parë vullnetin nëpërmjet një kërkesë me shkrim. Ndërsa në rastin kur ndërtimi pa leje disponohet nga më

LISTA ME PËRFITUESIT

| ISHTE - BËHET | NR. I TRASHËGIMTARËV E NË VKM-në E | EMRI | ATËSIA | MBIEMRI |
|---------------|------------------------------------|----------|--------|---------|
| BËHET | 72 | SABAUDIN | IBRAHI | KOBURJA |
| BËHET | 73 | RESHIT | IBRAHI | KOBURJA |

| LIDHJA C | | | | |
|------------------------------|---------|-----------|-----------|---------------|
| VKM NR. 901, DATË 12.12.2012 | | | | |
| ISHTE | 618 | HAKI | SALI | ALLA |
| | 619 | SANIJE | SALI | JAKU (ALLA) |
| | 620 | SUZANA | REXHEP | ALLA |
| | 621 | SALI | REXHEP | ALLA |
| | 622 | DRITAN | REXHEP | ALLA |
| | 623 | FATJON | REXHEP | ALLA |
| | 624 | NEVRUZ | HATEM | PELIVANI |
| | 625 | JETA | HATEM | PELIVANI |
| | 626 | VERA | HATEM | PELIVANI |
| | 627 | VALENTINA | HATEM | PELIVANI |
| | 628 | OGERT | RAMADA | PELIVANI |
| | 629 | BEDRI | HAXHI | ALLA |
| | 630 | MYZEJENE | SHEFQET | ALLA |
| | 631 | SKËNDER | SHEFQET | ALLA |
| | 632 | MEREME | SHEFQET | ALLA (BEHAND) |
| | 633 | FATBARDHA | HAMDI | ALLA (MULLAJ) |
| 634 | FATMIRA | HAMDI | ISMAILI (| |
| 635 | FIQIRET | HAMDI | ALLA | |
| 636 | HAXHI | HAMDI | ALLA | |
| 637 | FIQIRI | HAMDI | ALLA | |
| BËHET | 74 | BEDRI | HAXHI | ALLA |
| | 68 | MYZEJENE | SHEFQE | ALLA |
| | 69 | SKENDER | SHEFQE | ALLA |
| | 70 | MEREME | SHEFQE | ALLA |
| | 71 | FATBARDHA | HAMDI | ALLA |
| | 72 | FATMIRA | HAMDI | ALLA |
| | 73 | FIQIRET | HAMDI | ALLA |
| | 74 | HAXHI | HAMDI | ALLA |
| 75 | FIQIRI | HAMDI | ALLA | |

| LIDHJA C | | | | |
|------------------------------|---------|-----------|-----------|---------------|
| VKM NR. 901, DATË 12.12.2012 | | | | |
| ISHTE | 618 | HAKI | SALI | ALLA |
| | 619 | SANIJE | SALI | JAKU (ALLA) |
| | 620 | SUZANA | REXHEP | ALLA |
| | 621 | SALI | REXHEP | ALLA |
| | 622 | DRITAN | REXHEP | ALLA |
| | 623 | FATJON | REXHEP | ALLA |
| | 624 | NEVRUZ | HATEM | PELIVANI |
| | 625 | JETA | HATEM | PELIVANI |
| | 626 | VERA | HATEM | PELIVANI |
| | 627 | VALENTINA | HATEM | PELIVANI |
| | 628 | OGERT | RAMADA | PELIVANI |
| | 629 | BEDRI | HAXHI | ALLA |
| | 630 | MYZEJENE | SHEFQET | ALLA |
| | 631 | SKËNDER | SHEFQET | ALLA |
| | 632 | MEREME | SHEFQET | ALLA (BEHAND) |
| | 633 | FATBARDHA | HAMDI | ALLA (MULLAJ) |
| 634 | FATMIRA | HAMDI | ISMAILI (| |
| 635 | FIQIRET | HAMDI | ALLA | |
| 636 | HAXHI | HAMDI | ALLA | |
| 637 | FIQIRI | HAMDI | ALLA | |
| BËHET | 74 | BEDRI | HAXHI | ALLA |
| | 68 | MYZEJENE | SHEFQE | ALLA |
| | 69 | SKENDER | SHEFQE | ALLA |
| | 70 | MEREME | SHEFQE | ALLA |
| | 71 | FATBARDHA | HAMDI | ALLA |
| | 72 | FATMIRA | HAMDI | ALLA |
| | 73 | FIQIRET | HAMDI | ALLA |
| | 74 | HAXHI | HAMDI | ALLA |
| 75 | FIQIRI | HAMDI | ALLA | |

| LIDHJA D | | | | | |
|-----------------------------|-----------|-------------|--------------|--------------|------------|
| VKM NR. 449, DATË 27.5.2015 | | | | | |
| ISHTE | 440 | LAVDIJE | ASTRIT | KADILLI | |
| | 441 | LILJANA | ASTRIT | KADILLI | |
| | 442 | MEHMET | ASTRIT | KADILLI | |
| | 443 | MEREME | HASAN | ALUSHI | |
| | 444 | ZYRA | VELI | MARKU (SINA) | |
| | 445 | MARJETA | VELI | LEKA (SINA) | |
| | 446 | ZHANETA | VELI | DHAMO (SINA) | |
| | 447 | BASHKIM | VELI | SINA | |
| | 448 | EDMOND | VELI | SINA | |
| | 449 | EDUART | VELI | SINA | |
| | 450 | QEMAL | ISUF | SINA | |
| | 451 | MIMOZA | XHEVDET | HADO | |
| | BËHET | 76 | AGIM | HASAN | ALUSHI |
| | | 77 | ANILA | QEMAL | LEVENISHTI |
| | | 78 | ARBEN | HASAN | ALUSHI |
| | | 79 | ARJAN | ASTRIT | KADILLI |
| 80 | | BASHKIM | VELI | SINA | |
| 81 | | DRITA | XHEVDE | KAMA (HADO) | |
| 82 | | EDUART | VELI | SINA | |
| 83 | | ELIDA | SEFEDIN | AGOLLI | |
| 84 | | EMINE | QEMAL | SPAHIU | |
| 85 | | HENRIETA | SEFEDIN | BALLIU | |
| 86 | | ENGJELLUSHE | SEFEDIN | AGOLLI | |
| 87 | | ISUF | QEMAL | SINA | |
| 88 | | KUJTIM | XHEVDE | HADO | |
| 89 | | LAVDIE | ASTRIT | KUTELI | |
| 90 | | LILJANA | ASTRIT | KADILLI | |
| 91 | | MARJETA | VELI | LEKA (SINA) | |
| 92 | MEHMET | ASTRIT | KADILLI | | |
| 93 | MEREME | HASAN | BUHARAJA | | |
| 94 | MERITA | XHEVDE | HADO | | |
| 95 | MIMOZA | XHEVDE | HADO | | |
| 96 | SANIJE | ISMAIL | SINA | | |
| 97 | SEMIRAMIZ | XHEVDE | HADO | | |
| 98 | ZHANETA | VELI | DHAMO (SINA) | | |
| 99 | ZYRA | VELI | MARKU (SINA) | | |

| LIDHJA E | | | | |
|-----------------------------|-------------|-------|--------|--|
| VKM NR. 801, DATË 30.9.2015 | | | | |
| 464 | FIQIRI | ALUSH | BALZA | |
| 465 | SHAQIR | RIZA | LUNIKU | |
| 466 | LINDITA | SURJA | XHIXHA | |
| 467 | ARLIND | AGIM | BALZA | |
| 468 | ENGJELLUSHE | ALUSH | BALZA | |

| | | | | |
|-------|----------------|----------------|-----------------|---------------|
| ISHTE | 469 | FLORA | RAMAZA | BALZA |
| | 470 | IKBAL | ALUSH | BALZA |
| | 471 | SHAZIME | MUSTAFA | LUNIKU |
| | 472 | SURJA | SHERIF | XHIXHA |
| | 473 | HYQMET | RIZA | LUNIKU |
| | 474 | ERVIN | MUSTAFA | LAMÇJA |
| | 475 | BENON | MUSTAFA | LAMÇJA |
| | 476 | LILJANA | MUSTAFA | LAMÇJA |
| | 477 | VJOLLCA | ZIJA | LUNIKU |
| | 478 | DASHAMIR | RIZA | LUNIKU |
| 479 | LUMBINE | ZIJA | LUNIKU | |
| 480 | MERITA | MUSTAFA | LAMÇJA | |
| 481 | ELISABETA | SURJA | XHIXHA | |
| 482 | MILI (XHEMILE) | RIZA | LUNIKU | |
| BËHET | 483 | PRANVERA | ALUSH | BALZA |
| | 484 | ROVENA | AGIM | BALZA |
| | 485 | VALTER | ZEQIR | HOXHA |
| | 486 | ABDURRAHMAN | | LUNIKU |
| | 487 | SEIT | | LUNIKU |
| | 488 | SELIM | | LUNIKU |
| | 489 | NEXHMIFE | | Qafa |
| | 490 | FERIT | BEHXHET | LUNIKU |
| | 491 | SYPHIJE | BEHXHET | LUNIKU |
| | 492 | KUME | | LUNIKU |
| BËHET | 493 | NUREDIN | BEHXHE | LUNIKU |
| | 494 | SAMI | BEHXHET | LUNIKU |
| | 495 | BASHKIM | BEHXHET | LUNIKU |
| | 496 | BURBUQE | HAJDAR | SHTRAZA |
| | 497 | VJOLLCA | HAJDAR | SELITA |
| | 498 | HATIXHE | HAJDAR | BAJRAKTARI |
| | 499 | AHMET | HAJDAR | ISAJ |
| | 500 | LINDITA | KUJTIM | AGOLLI |
| | 501 | BESA | KUJTIM | ISAJ |
| | BËHET | 100 | DASHLAMIR | RIZA |
| 101 | | ELISABETA | SURJA | XHIXHA |
| 102 | | FLORA | RAMAZA | BALZA |
| 103 | | HYQMET | RIZA | LUNIKU |
| 104 | | MILI (XHEMILE) | RIZA | LUNIKU |
| 105 | | SHAZIME | MUSTAF | LUNIKU |
| 106 | | SURJA | SHERIF | XHIXHA |
| 107 | | ERVIN | MUSTAF | LAMÇJA |
| 108 | | LILJANA | MUSTAF | LAMÇJA |
| 109 | | LUMNIJE | ZIJA | LUNIKU |
| 110 | MERITA | MUSTAF | LAMÇJA | |
| 111 | VJOLLCA | ZIJA | LUNIKU | |
| 112 | AHMET | HAJDAR | ISAJ | |
| 113 | LINDITA | SURJA | XHIXHA | |
| 114 | ABDURRAMAN | | LUNIKU | |
| 115 | BENON | MUSTAF | LAMÇJA | |
| 116 | SEIT | | LUNIKU | |
| 117 | SELIM | | LUNIKU | |
| 118 | NEXHATIFE | | Qafa | |
| 119 | SHAQIR | RIZA | LUNIKU | |
| 120 | FERIT | BEHXHE | LUNIKU | |
| 121 | SYPHIJE | BEHXHE | DYLGJERI | |
| 122 | KUME | | LUNIKU | |
| 123 | BASHKIM | BEHXHE | LUNIKU | |
| 124 | BURBUQE | HAJDAR | SHTRAZA | |
| 125 | VJOLLCA | HAJDAR | SELITA | |
| 126 | HATIXHE | HAJDAR | BAJRAKTARI | |
| 127 | LINDITA | KUJTIM | AGOLLI | |
| 128 | BESA | KUJTIM | ISAJ | |
| 129 | VALTER | ZEQIR | HOXHA | |
| 130 | PRANVERA | ALUSH | BALZA | |
| 131 | IKBAL | ALUSH | BALZA | |

| | | | | | |
|-------|--------------|----------------|--------------|---------------|----------|
| ISHTE | 132 | ENGJELLUSHE | ALUSH | BALZA | |
| | 133 | FIQIRI | ALUSH | BALZA | |
| | 134 | ROVENA | AGIM | BALZA | |
| | 135 | ARLIND | AGIM | BALZA | |
| | 136 | HILMIJE | | KRYPA | |
| | 137 | FATOS | | LUNIKU | |
| | 138 | LAVDIJE | | DOMI | |
| | 139 | SAMI | BEHEXH | LUNIKU | |
| | 140 | SUZANA | MUSTAF | LUNIKU | |
| | 141 | ALFONC | NUREDI | LUNIKU | |
| 142 | AGIM | NUREDI | LUNIKU | | |
| 143 | ANI | KUJTIM | HOXHA | | |
| 144 | MERLIN | NEXHDE | HOXHA | | |
| 145 | ANILA | KUDRET | HOXHA | | |
| BËHET | 44 | BARDHYL | | ABAZI | |
| | 45 | FATIME | | DEDJA | |
| | 46 | HATIXHE | | BALLA | |
| | 47 | HAXHIRE | | BOKSHI | |
| | 48 | HAZIZ | | ABAZI | |
| | 49 | KAJE | | MUMAJESI | |
| | 50 | KUMERI | | BALLA | |
| | 51 | KUMERI | | BALLA | |
| | 52 | MALIQ | | ABAZI | |
| | 53 | MUHARREM | | ABAZI | |
| 54 | MUSA | | ABAZI | | |
| 55 | OSMAN | | ABAZI | | |
| 56 | RAZIJE | | RAUFI | | |
| 57 | SHEQERE | | ABAZI | | |
| 58 | SHERIFE | | ABAZI | | |
| 59 | VELI | | ABAZI | | |
| 60 | XHARIJE | | ABAZI | | |
| 61 | XHARIJE | | ABAZI | | |
| 62 | XHEMILE | | ABAZI | | |
| 148 | REFIK | HAXHI | ABAZI | | |
| 149 | BARDHYL | | ABAZI | | |
| 150 | FATIME | | DEDJA | | |
| 151 | HATIXHE | | BALLA | | |
| 152 | HAZIZ | | ABAZI | | |
| 153 | KAJE | | MUMAJESI | | |
| 154 | KUMERI | | BALLA | | |
| 155 | MALIQ | | ABAZI | | |
| 156 | MUHARREM | | ABAZI | | |
| 157 | MUSA | | ABAZI | | |
| 158 | OSMAN | | ABAZI | | |
| 159 | RAZIJE | | RAUFI | | |
| 160 | SHEQERE | | ABAZI | | |
| 161 | SHERIFE | | ABAZI | | |
| 162 | VELI | | ABAZI | | |
| 163 | XHARIJE | | ABAZI | | |
| 164 | XHEMILE | | ABAZI | | |
| 165 | HAXHIRE | | BAKALLI | | |
| BËHET | 367 | FERIT | ISUF | LAKASI | |
| | 146 | FERIT | ISUF | LAKASI | |
| | 368 | REFIK | MILAZIM | MUCA | |
| | 147 | REFIK | MILAZIM | MUCA | |
| | BËHET | 44 | BARDHYL | | ABAZI |
| | | 45 | FATIME | | DEDJA |
| | | 46 | HATIXHE | | BALLA |
| | | 47 | HAXHIRE | | BOKSHI |
| | | 48 | HAZIZ | | ABAZI |
| | | 49 | KAJE | | MUMAJESI |
| 50 | | KUMERI | | BALLA | |
| 51 | | KUMERI | | BALLA | |
| 52 | | MALIQ | | ABAZI | |
| 53 | | MUHARREM | | ABAZI | |
| 54 | MUSA | | ABAZI | | |
| 55 | OSMAN | | ABAZI | | |
| 56 | RAZIJE | | RAUFI | | |
| 57 | SHEQERE | | ABAZI | | |
| 58 | SHERIFE | | ABAZI | | |
| 59 | VELI | | ABAZI | | |
| 60 | XHARIJE | | ABAZI | | |
| 61 | XHARIJE | | ABAZI | | |
| 62 | XHEMILE | | ABAZI | | |
| 148 | REFIK | HAXHI | ABAZI | | |
| 149 | BARDHYL | | ABAZI | | |
| 150 | FATIME | | DEDJA | | |
| 151 | HATIXHE | | BALLA | | |
| 152 | HAZIZ | | ABAZI | | |
| 153 | KAJE | | MUMAJESI | | |
| 154 | KUMERI | | BALLA | | |
| 155 | MALIQ | | ABAZI | | |
| 156 | MUHARREM | | ABAZI | | |
| 157 | MUSA | | ABAZI | | |
| 158 | OSMAN | | ABAZI | | |
| 159 | RAZIJE | | RAUFI | | |
| 160 | SHEQERE | | ABAZI | | |
| 161 | SHERIFE | | ABAZI | | |
| 162 | VELI | | ABAZI | | |
| 163 | XHARIJE | | ABAZI | | |
| 164 | XHEMILE | | ABAZI | | |
| 165 | HAXHIRE | | BAKALLI | | |
| BËHET | 92 | VIKTOR | FILIP | ASHIKU | |
| | 166 | VIKTOR | FILIP | ASHIKU | |

| | | | | | |
|-------|-----------------------------|-----------|-----------------|-------------|---------|
| BËHET | LIDHJA H | | | | |
| | VKM NR. 230, DATË 21.3.2017 | | | | |
| | ISHTE | 92 | VIKTOR | FILIP | ASHIKU |
| | BËHE | 166 | VIKTOR | FILIP | ASHIKU |
| | LIDHJA I | | | | |
| | VKM NR. 367, DATË 26.4.2017 | | | | |
| | ISHTE | 517 | AGRON | EQEREM | FISHITA |
| | | 518 | AGIM | EQEREM | FISHITA |
| | | 519 | MYNEVERE | EQEREM | FISHITA |
| | | 520 | SHPRESA | | FISHITA |
| 521 | | TOMORR | EQEREM | FISHITA | |
| 522 | | VOLTAN | REXHAI | FISHITA | |
| 167 | | REXHAI | | FISHITA | |
| 168 | | MYNEVERE | | FISHITA | |
| 169 | | AGIM | | FISHITA | |
| 169 | | TOMORR | | FISHITA | |
| 170 | AGRON | | FISHITA | | |
| 171 | PETRIT | | LILA | | |
| 172 | TOMORR | | LILA | | |
| 173 | EQEREM | | LILA | | |
| 174 | DIANA | | MANSAKU | | |
| 175 | FATBARDHA | | MANE | | |
| 176 | HAMIDE | | GRABOLLI | | |
| 177 | LINDITA | | SHKODRA | | |
| 178 | HYLVIFE | | QELA | | |
| 179 | SUZANA | | QELA | | |
| 180 | EMINE | | DAUPI | | |
| 181 | MUAZEZ | | QELA | | |
| 182 | MUHAMED | | QELA | | |
| 183 | ISMAIL | | QELA | | |
| ISHTE | 406 | Mahmut | | Shengjergji | |
| | 407 | Leme | | Shengjergji | |
| | Trashëgimtarët-30 | | | | |
| | 37 | MILI | MAHMUT | SHINGJERGJI | |
| | 38 | MEREME | IBRAHIM | SHINGJERGJI | |
| | 39 | BARDHYL | ALI | SHINGJERGJI | |
| | 40 | ALEM SHAH | ALI | SHINGJERGJI | |
| | 41 | MAHMUT | ALI | SHINGJERGJI | |
| | 42 | LIRI | ALI | SHINGJERGJI | |
| | 43 | EDUART | ALI | SHINGJERGJI | |
| 44 | DASHURI | ALI | SHINGJERGJI | | |
| 45 | HILMI | HAMIT | SHINGJERGJI | | |
| 46 | SHEMSI | | MAVJANI | | |
| 47 | TEUTA | SHEMSI | MAVJANI | | |
| 48 | SOKOL | SHEMSI | MAVJANI | | |
| 49 | LIRI | | SHINGJERGJI | | |
| 50 | NEVJANA | | SHINGJERGJI | | |
| 51 | ABDULLAH | | BALLHYSA | | |
| 52 | VJOLLCA | | BALLHYSA | | |
| 53 | RUZHDIJE | | SHINGJERGJI | | |
| 54 | HASAN | | MATRAXHIU | | |
| 55 | HEDIJE | | MATRAXHIU | | |
| 56 | AIDA | | MATRAXHIU | | |
| 57 | SAMIR | | MATRAXHIU | | |
| 58 | VANTHI | | SHINGJERGJI | | |
| 59 | ARMAND | | SHINGJERGJI | | |
| 60 | LINDITA | | SHINGJERGJI | | |
| 61 | MANJOLA | | SHINGJERGJI | | |
| 62 | LORETA | | SHINGJERGJI | | |
| 63 | KRISTO | | SHINGJERGJI | | |
| 64 | ALBERT | | SHINGJERGJI | | |
| 65 | MENCURI | | SHINGJERGJI | | |
| 66 | FLUTURAKE | | SHINGJERGJI | | |
| TE | 403 | MAHMUT | | SHENGJERGJI | |
| | 404 | LEME | | SHENGJERGJI | |

VLONJATËT GJEJNË ZGJIDHJEN PËR TURISTËT, PREZANTOJNË RESTORANT "BABALJA"

SUMMER

pages


SUPLEMENT I GAZETIA SHQIPTARE

E enjte 26 Korrik 2018



META
FESTON


**Meta le presidencën dhe i
bashkohet miqësisë së LSI-së**



**Disa mënyra për
të luftuar stresin**



• **Agron Duka i rrëfen
të gjitha: Zili për Fatos
Nanon, episodi me
Olldashin dhe çfarë ka në
plan opozita**
• **Spartak Ngjela flet për
marrëdhëniet me femrat:
Ja pse nuk jam martuar**



**STRESI DHE KEJSI
RREFEJNE DASHURINE:**

**Nga njohja tek dy javët në
arrati, takimet fshehtas në
Europë dhe celebrimi pa bujë**

Çifti rrëfen ekskluzivisht në "RevistaWho.Com" edhe planet për ta lënë përgjithmonë Shqipërinë si dhe zbulojnë një lajm të keq për të gjithë adhuruesit e muzikës së Stresit: ai po përgatit albumin e fundit muzikor, ku do të tregojë të gjitha të vërtetat e tij, sepse tani e tutje e para do të jetë familja, e cila do të gëzohet me një dasmë të madhe, kur ai ta vendosë.

Stresi dhe Kejsi rrëfejnë dashurinë: Nga njohja te dy javët në arrati, takimet fshehtas në Europë dhe celebrimi pa bujë

Këngëtari i hitit "Love Story" rrëfen për herë të parë dhe ekskluzivisht në "RevistaWho.Com" historinë e tij të dashurisë, që nisi me një porosi nga nëna e Kejsit për t'ia ruajtur vajzën dhe që përfundoi në një lidhje plot me të papritura.

Nga Eraldo Rexho

Djali i prapë dhe vajza e mbarë. Rrugët që u kryqë zuan për të bashkuar dy njerëz kaq të ndryshëm në një udhëtim të përbashkët. Pasion, xhelozit, dashuri, arrati, ikje, rikthime, telefonata disaorëshe, takime në Europë e një udhëtim i pazakontë në Tropojë mes deborës. Çdo gjë në sekret të plotë, larg syve të botës, larg vëmendjes së familjes, larg të gjithëve e kaq pranë njëri-tjetrit. Ai dhe ajo në më shumë se tri vite në një rrëfim të denjë për skenar kinemaje. Historia e tyre ka brenda romancën, komedinë dhe aksionin...

Stresi dhe Kejsi, rrëfejnë pa doreza gjithçka për lidhjen e tyre, që nga prezantimi i rastësishëm që ju bëri mamaja e vajzës, te dita e parë kur u takuan, javët në arrati maleve të Shqipërisë pa dijeninë e prindërve të saj. Është një histori takimesh të fshehta nëpër botë, janë orë të gjata bisedash në 'Skype' që e linin hapur edhe gjatë natës për t'i thënë të parët 'mirëmëngjes' njëri-tjetrit. Rrëfimi i tyre përfundon te celebrimi pa shumë bujë i dashurisë së tyre 3-vjeçare, tamam siç Kejsi donte. Zbuloni vajzën që Stresi ia mbajti fshehur botës, vajzën që e dëshoi vetëm për vete, në një intervistë kur flasin të dy, për të plotësuar njëri-tjetrin.

Si ka nisur historia juaj e dashurisë?

STRESI: Ka nisur në lagje përpara 3 vitesh e gjysmë. Unë njihja mamin e Kejsit nëpërmjet vëllait tim, iu prezantova asaj si djali i



vogël i familjes. Pak më vonë kaluan Kejsi dhe motra e saj, por unë nuk i kushtova shumë rëndësi. Ditën tjetër mami Kejsit më kërkoi të bëjmë një foto bashkë dhe unë pranova, pasi mbaroi tha që donin edhe vajzat foto, por ato ikën.

KEJSI: Ne u fshëm në atë moment te makina (qesh).

STRESI: Dhe kështu nisi, secili ka sekretin e tij të përjetimit.

KEJSI: Ka nisur me prekje në krah. Unë atë ditë që kam kaluar kam qenë e palyer dhe nuk kam

dashur që të më shohë, por mami na prezantoi. Unë thjesht e përshëndeta dhe ktheva kokën që të mos më shihte. Në atë moment e preka në krah dhe ai mendoi se unë e preka nga inati. Pastaj më qerasi nëpër lagje dhe unë e shikojta dhe mendoja: 'Po ky mirë njëherë për respekt të mami, po përherë ç'kuptim ka'... Kam qenë unë e para që i kam shkruar dhe i thashë: "Faleminderit për respektin, por po na fut në borxh". Stresi nuk ishte tipi që të ngacmonte, shikonte

punën e tij.

STRESI: Nëna e Kejsit më la porosi t'ia ruaja vajzën nga çunat e lagjes, që mund ta ngacmonin (qesh).

Kafen e parë pas sa kohësh e keni pirë së bashku?

KEJSI: Polëm disa ditë dhe më ftoi për darkë, por mua nuk më lejonte mami dhe i thashë 'jo, nuk mundem'. Dhe ai më tha që nëse nuk më lejonte mami as ai vetë nuk donte. Si përfundim nuk e lamë për darkë, por për kafe, në lagje madje.

STRESI: Ishte këmbëngulja e fillimit, doja patjetër ta takoja. Kur u takuam unë prita që të ishte një përshëndetje e thjeshtë meqë kishim folur vetëm në 'Instagram', por Kejsi m'u hodh në qafë.

KEJSI: Mos e ekzagjero (qesh). Çështja ishte që ne flisnim 24 orë dhe unë nuk mund t'i rrija me turinj. Unë po ecja para dhe kur arrita te shkallët, siç isha u ktheva dhe i hapa krahët. Ky u çudit shumë, dukej që nuk e prishte.

STRESI: I kam thënë por i vjen inat, unë i bëj për vete të gjithë njerëzit (qesh).

Çfarë të pëlqeu te Kejsi kur e ke parë për herë të parë?

STRESI: Më ka pëlqyer si 'kallëp' e para (qesh). Bëj shaka se në fakt e kam pëlqyer si vajzë në fillim, pastaj e njoha më tepër. Sigurisht që kam parë vetitë e saj, karakterin dhe familjen nga e cila vjen, janë shumë gjëra.

Është e rëndësishme për ty familja e vajzës me të cilin do krijosh një marrëdhënie?

STRESI: Po patjetër, familja është e para.

KEJSI: Kur ka nisur marrëdhënia jonë ishim 'ne kundër botës', pasi Arkimedi është person publik dhe unë nuk e dija si do e prishte familja ime, ndërsa familjen e tij nuk e kisha takuar akoma.

STRESI: Unë isha edhe problematik në atë kohë, ishte kulmi im atëherë.

KEJSI: Prandaj e mbajtëm të fshehtë për shumë kohë, derisa u sigurua që djali → do shtruhej (qesh). Kishim



← idenë që nëse ne do jemi mirë me njëri-tjetrin edhe familjet do na pranojnë. Dhe ashtu ndodhi, tashmë edhe familjet tona janë shumë të lidhura.

Ka pasur në ndonjë moment kundërshtim nga familjet?

KEJSI: Ka pasur kundërshtim në momentin që kanë dalë fotot në internet, sepse familja ime nuk e dinte. Babi kishte zbuluar rastësisht në telefonin tim foto me Stresin, por unë për të qetësuar gjendjen i thashë që jemi ndarë dhe që ka ikur në Spanjë, pasi në atë kohë ai iku vërtet në Spanjë. Në të vërtetë ne vazhduam dhe e mbajtëm të fshehtë pasi unë nuk isha gati të tregoja çdo gjë në familje. Dhe kur dolën fotot ata mendonin që ne i kishim ndërprerë marrëdhëniet, prandaj ju erdhi e papritur. Ndërsa ne ishim akoma bashkë dhe takoheshim te kati -2 në pallat. Mamit ia tregova të parës kur dolën fotot, madje ishim në makinë dhe i thashë 'ndaloje se kam një lajm'. Ajo u mërziq sepse nuk e prishte dhe më shumë për faktin që u bënë gjërat aq publike, sepse me Arkimedin nuk kishte asgjë. Unë jetoja jashtë, lidhje me rrjetet nuk kisha, por ne përfituam nga ai rast për ta pranuar që ishim bashkë.

Sa vite keni bashkë?

KEJSI: 3 vite e gjysmë.

Kejsi, në momentet e 'çmendurisë' së Stresit si i ke përjetuar gjërat?

KEJSI: Unë jam tip i tillë, diçka

ose më intereson shumë deri në çmenduri, ose nuk më intereson fare. Dhe për Stresin mua më 'çmend' çdo gjë.

STRESI: Është xhelozë në maksimum, nuk e ke idenë sa shumë (qesh).

KEJSI: Jo, nuk jam xhelozë, madje jam shumë e kuptueshme. Por fakti që unë jam njëri i thjeshtë dhe që në krah kam një person publik ndikon. Unë jam shumë e qetë, por kam inat mungesën e korrektësisë, madje kjo ka qenë arsyeja pse shpesh kemi pasur zënka. Ka ndikuar edhe fakti që lidhjen e kemi mbajtur në distancë dhe ka qenë shumë e vështirë. Nëse nuk tregon korrektësi për diçka kaq të vogël sa ora, si mund ta mbash një lidhje nga Kanadaja në Shqipëri?

Si ka funksionuar lidhja juaj në distancë? Çfarë ka ndodhur gjatë asaj kohe?

KEJSI: Takoheshim në Europë. Sa herë unë kisha mundësi nga shkolla, ai vinte më takonte në një shtet të caktuar. Ndërsa këtë jo asnjëherë, madje fshiheja kur vija këtu se kishim frikë mos na shikonin.

STRESI: Madje ka ndodhur edhe që jemi arratisur të dy. Unë do nise-sha për koncert në Greqi kur më telefonon babi dhe më thotë që isha në kërkim. Marr makinën bashkë me Kejsin dhe ikim. Mbjaj mend që ishte dëborë e madhe dhe ikëm për në Tropojë, madje më ka ikur mak-

ina dy herë nga duart sepse rrëshqiste. Asnjë nuk futej në atë rrugë, por unë u futa dhe nga. Policia më kërkonte unë kisha ngecur në dëborë. Disa njerëz më njohën dhe e dinin që isha në kërkim, por më ndihmuan duke vënë zinxhir te gomat dhe ndenjën me ne.

KEJSI: Kjo ka qenë hera e parë që unë kam ardhur në Shqipëri për ta takuar dhe aty kam kuptuar që e dua vërtetë. Unë isha veshur shumë trashë sepse bënte shumë ftohtë, ndërsa Stresi kishte vetëm me një pulovër dhe atlete. Del nga makina dhe mundohet të heqë dëborën që kishte ngecur në rrota me duar. Unë doja ta ndihmoja, por ai nuk më la të dal nga makina për asnjë moment, më thoshte të rrija ngrohtë brenda. Kur hyri në makinë kishte ngrirë, ishte shumë i ftohtë dhe nuk më lejonte ta prekja, sepse kishte frikë mos ftoheshja unë. Aty kuptova sa i kujdesshëm ishte për mua.

Sa ditë keni ndenjur në arrati?

STRESI: Shumë kemi ndenjur, 2 javë.

Po prindërit e tu Kejsi çfarë bënë?

KEJSI: Ata nuk e dinin që isha në Shqipëri, mendonin se isha në shkollë pasi ne u takuam fshehtas. Dhe telefonatat nuk i hapja me numër, por 'Whatsapp' që të mos kuptohej numri. Motra ime madje e kishte lexuar në portale që ai ishte në kërkim dhe më thotë mua, por unë i thashë që gënjëjnë por-

talet.
STRESI: Problemi në këtë mes ishte babi im. Ai më bërtiste pse e kisha marrë me vete gocën (Kejsin) dhe nuk pranonte ta takonte atë sepse familja e saj nuk dinte gjë.

Marrëdhënia e Stresit me vjehrrën sot si është?

KEJSI: Kur vjen mami me makinë e dalloj gjithmonë sepse ngre muzikën e Stresit në maksimum. Kudo që shkon dëgjon këngët e tij. Mami im dhe Arkimedi janë tipa të njëjtë dhe e di çfarë na ndodh. Kur më shohin mua me mamin e tij i thonë sa të mirë e ke vazhën, ndërsa kur ishte një ditë Stresi te shtëpia ime erdhi pas-truesja dhe ju drejtua mamit duke i thënë: "Sa të qenka rritur djali", - ngaqë edhe ngjajnë.

STRESI: Dhe unë u detyrova të sqaroja situatën, që jam dhëndri jo djali se i biri është 12 vjeç kurse dhëndri 32.

Sa vite diferencë keni?

KEJSI: Kemi 9 vite diferencë.

Kur i ke takuar për herë të parë mamin dhe babin e Stresit, çfarë të kanë thënë?

KEJSI: Si fillim dua të them që janë njerëz shumë të mirë, fantastikë. Por kam takuar gjyshin të parin dhe gjithçka shkoi shumë mirë.

Si ishte për ty Stresi që pas gjithë eksperimenteve, nga 'bad boy' të ktheshesh në djalin e mirë?

STRESI: Unë vazhdojë të jemi 'bad boy', por jo në kuptimi djalë i keq, por djalë i prapë. Ne e kemi si rraçë këtë, mbas të 35-ave i thërrasim mendjes (qesh), i përkushtohem familjes, madje fillojmë shëndoshemi. Por Shqipëria nuk do më bëjë mirë, them të largohem, duhet ndryshim. Nuk do të jetë e thjeshtë, muzika është e rëndësishme dhe i kam kushtuar jetën, jam munduar ta lë, por kthehem prapë. Janë 11 vite investim, por familja është më e rëndësishmja.

Ke provuar t'i kushtosh ndonjë këngë Kejsit?

STRESI: Ja kam kushtuar, është kënga 'Femër prej Shqipërie'. Kur e nxora i thashë ta gëzosh. Madje në atë kohë nuk flisnim fare, më kishte bërë 'block' në çdo rrjet social dhe gjithçka. Në 'Instagram' kemi vendosur të mos ndjekim njëri-tjetrin, ajo mund të ma shohë në 100 mënyra, unë e kam më të vështirë.

KEJSI: Po në 'Instagram' nuk i bëj 'follow', sepse më vijnë të gjithë fansat e fllaktë të tij. Madje zihemi për fotot që hedh me mua. I them fshiji gjithmonë se më duket sikur na 'kap syri'.

A është e vështirë kjo marrëdhënia me mesazhe dhe telefonata? Sa ka qenë telefonata më e gjatë mes jush?

KEJSI: 3 orë më duket, por ne flinim me kamera hapur dhe kur zgjohej Stresi më thërriste. Kështu zgjoheshja edhe unë, ndonjëherë trembeshja.

STRESI: E ka pasur metodë për të më ruajtur (qesh).

KEJSI: A ruhet ky? E kemi parë që ka ikur edhe nga ballkoni. Unë them gjithmonë po të mos jem në shtëpi me të nuk fle, se e di që po bën diçka, më ndizet radari. Ka gjithmonë një mënyrë që të mbërrijë lajmi tek unë edhe kur nuk më tregon ai dhe kjo lidhet me faktin që është person publik. Mua më tregonin ku ishte dhe e pyesja, ai më thoshte jam në lagje, dhe nuk e pranonte derisa i çoja foto e kështu zbulonte 'spionin' dhe shkonte zihje me to (shoqet e mia).

Ka plane për martesë?

KEJSI: Ne të martuar jemi, por nuk

kemi bërë dasmë. Planet i kemi, por me kismet, sepse është pak vështirë. Unë kam familjen jashtë dhe Stresi është duke mbaruar albumin e fundit. Unë e mbështes në karrierë, por për të dy ai duhet ta bëjë këtë gjë, kur t'i mbyllë të gjitha dhe të bëhen letrat për të ikur jashtë do bëjmë dasmën.

Prado t'i japësh fund me muzikën, ky është plani yt?

STRESI: Plani im për karrierën është ta mbyll me një album që do i bëjë të gjithë të qajnë. Do tregojë prapaskanat e reperave, do tregoj gjithçka që njerëzit nuk dinë, çdo gjë të 'neveritshme' që ata kanë bërë, nëpërmjet tekstit të këngës. Unë nuk kam qenë këngëtar, por misionar në muzikë.

Çfarë mendon të bësh pas muzikës?

STRESI: Të ikim njëherë dhe atje ku do shkoj do e bëj 'bellgun' tim siç kam bërë gjithmonë. Diku larg Shqipërisë.

Të bezdis ty Kejsi vëmendja që ju kushtojnë të dyve?

KEJSI: Mua po, sepse jam tip i mbyllur. Nuk dua të jem modelja, por fotografa. Unë dua gjërat e thjeshta dhe televizionin apo gjërat e ngjashme me të nuk i dua fare.

A ka qenë Stresi një nga artistët e tu të preferuar?

KEJSI: Ai është i vetmi artist shqiptar që unë dua të dëgjoj, pavarësisht se më ka rastisur të dëgjoj edhe të tjerë. Ndërsa më parë unë nuk e dija sa i madh ishte pasi jetoja në Kanada, madje jam çuditur kur kam parë si reagonin në koncert njerëzit për të. Kur ishim në shtëpi e prekja dhe thoja nuk mund ta besoj që ky është i dashuri im. Unë mendoj se Stresi është shumë i talentuar, por nuk i ka rënë karrierës mbrapa.

Si ka qenë fejsa juaj?

STRESI: Ne nuk kemi fejuar, jemi martuar direkt.

Po propozimi si ka qenë?

KEJSI: Unë nuk kam dashur kurrë të më ulet në gjunjë të të më bëjë një propozim, sepse do të sikletoseshja. Kemi vendosur shumë thjeshtë. Duke biseduar me familjet tona menduam për planet për njëri-tjetrin dhe vendosëm, pastaj ndamë datën. Shkëmbuem nishanet dhe ndoqëm të gjitha traditat e tjera shqiptare. U veshëm thjesht, mbledhëm njerëzit më të afërt dhe aq ishte. Celebrimi ishte siç doja unë ndërsa dasma do jetë sipas Stresit, siç do ai, e madhe.

E mendoni të keni një fëmijë?

KEJSI: Jemi akoma të rinj, duam të shijojmë kohën bashkë, do udhëtojmë dhe kur të vendosim do jetë padishim koha e duhur për të dy. Pashim të këtët vit si do jenë për ju?

STRESI: I kemi filluar në fakt. Kemi pushuar 5 ditë në Sarandë dhe kështu mendojmë t'i bëjmë edhe në vazhdim, të vendosim detinacionet dhe të ikim disa ditë në vende të ndryshme. Ne jemi nga ata njerëz që në 1 të natës ndajmë mendjen dhe nisemi. Me mua nuk bëhen plane për të nesërmen, vendos direkt.

Në 3 vite bashkë, çfarë urreni dhe doni më shumë të njëri-tjetrit?

KEJSI: Mua të gjitha më pëlqejnë te ai, vetëm pak gjëra nuk dua. Një ndër to është që gënjën kot për gjëra pa rëndësi, ndoshta e bën për të më nervozuar. Por ai do fillojë të mësohet me të vërtetën dhe nuk do bëjë më të tilla gjëra.

STRESI: Nuk dua xhelozinë, por e justifikoj dhe është një barrë që do e duroj. Ndërsa ajo që më pëlqen më shumë është thjeshtësia. Unë kurrë nuk kam dashur të kem të bëjë me një femër të showbiz-it. Kejsi është e fokusuar te unë dhe është dashuri e pastër e pa hile. Për më tepër ma do familja (qesh).



Ju mund ta dini se çfarë mëndesh ju stresojnë. Përpiqeni t'i ndryshoni, por më kot. Ato mbeten në trurin tuaj. Përsëriten e përsëriten vazhdimisht. Bashkë me to mbeten në trupin tuaj edhe ankthi, mërzia, zemërimi që i shfaqen. Nëse nuk mundeni t'i ndryshoni dot, ju të paktën, mund t'i kontrolloni ato. T'i ndaloni që të shprehin. T'i pakësoni, të minimizoni efektin e tyre mbi ju, madje edhe t'i shmangni, të paktën për një farë kohe.

Ja disa prej teknikave që mund të përdorni:

1- Ndalo mendimet që ju mërzisin. Qëllimi i kësaj teknike është që të ndërprisni rrjedhën e mendimeve stresuese. Me ndërprerjen e rrjedhës së tyre ju ndryshoni pasojën. Si? Shqërojeni mendimet stresuese me një pasojë negative (lloj ndëshkimi). Çdo sjellje që pasohet nga një ndëshkim ka prirjen që të mos përsëritet.


2- Zgjidhni një vend ku të mos ju shqetësojnë e as të mos shqetësojnë të tjerët. Mbështillni grushtin e dorës së majtë me një garzë ngjyese. (leukoplast) Shtrihuni diku e prisni disa sekonda. Pastaj filloni të mendoni rreth problemit që ju shqetëson me qëllim që të provokoni mendimet e pakëndshme. Sapo ato të fillojnë e të vërshojnë në trurin tuaj, thuaj "STOP" me sa zë të kini dhe çmbështillni leukoplastin. Mund t'ju dhëmb pakëz dora, por këtu qëndron lezeti. Fjala "STOP" e shoqëruar me dhimbjen e dorës shkakton ndërprerjen e rrjedhës së mendimeve stresuese.

3- Shtrihuni diku dhe lëreni veten tuaj të lirë. Mos i sillni mendimet e pakëndshme në mendjen tuaj në mënyrë të pavullnetshme. Thjesht lëreni mendjen tuaj të shkojë nga të dojë. Sapo mendimet e pakëndshme të fillojnë të shfaqen, thoni "STOP", me një zë normal dhe në të njëjtën kohë çmbështillni leukoplastin.

4- Shtrihuni diku dhe relaksohuni. Lëreni mendjen tuaj të shkojë nga të dojë. Mos u sforconi të mendoni. Sapo mendimet negative të shfaqen në trurin tuaj, mendoni fjalën "STOP". Çmbështillni njëkohësisht leukoplastin. Përsëriteni disa herë. Shtrihuni dhe lëreni mendjen tuaj të shkojë nga të dojë. Sapo mendimet negative të shfaqen në trurin tuaj mendoni vetëm "STOP", pa e çmbështjellë leukoplastin.

5- Dhe më tej, në situatë reale në jetë: sa herë që fillon vargu i mendimeve negative të shfaqet në mendjen tuaj, thoni "STOP", me mend. Ju s'mund të mendoni dy gjëra në të njëjtën kohë. Duke thënë "STOP", ju ndërprisni rrjedhën e mendimeve negative, duke mos e lejuar atë të ketë efektin e zakonshëm tek ju.

6- Ju mund të përdorni edhe një variant tjetër. Sa herë që mendimet negative vërshojnë në trurin tuaj, mendoni sikur ndriçohet para jush fjala "STOP" me drita neoni.



Disa mënyra për të luftuar stresin



7- Nuk është mirë që ta praktikoni këtë teknikë menjëherë, me shqetësimet që janë shumë shqetësuese për ju. Filloni shkallë-shkallë, njëherë me mendimet me pak shqetësuese, e gradualisht, me pas me ato që ju shqetësojnë më shumë.

8- Mos praktikoni në fillim kur nuk jeni me humor të mirë, apo kur vëmendja juaj është shumë e shpërqendruar. Nëse ju jeni shumë i depresionuar dhe keni përjetuar edhe mendime vetëvrasëse, praktikimi i kësaj teknike nuk ju ndihmon, por, përkundrazi mund ta thellojë turbullirën tuaj. Implorioni (përmbytja në fantazi)

9- Nëse në trurin tuaj shfaqet një mendim apo imazh negative, rri me të. Rrini me të në mendjen tuaj. Përpjetojeni e ripërpjetojeni disa herë. Përsëriteni atë disa herë me zë të lartë. Përsëriteni me zë të lartë atë që ju shqetëson aq herë, deri sa ta vëreni se ju qëndroni me të pa pasur ndonjë përjetim negativ.

10- Nëse ajo që shfaqet në mendjen tuaj është një imazh negativ, përshkruajeni përmbajtjen e këtij

imazhi disa herë me zë të lartë, aq herë sa ju të arrini ta përshkruani atë pa përjetuar ndonjë emocion negativ.

11- Sa herë që në mendjen tuaj të vërshojnë mendime negative, thoni "STOP" me mendjen tuaj. Fokusoheni vëmendjen tuaj në një objekt specifik. Vëzhgoni detajet e këtij objekti. Librin që jeni duke lexuar, filxhanin e kafesë, karrigen ku jeni ulur, vëzhgoni gjithçka që mund të vëzhgohet nga vendi ku jeni. Një objekt specifik.

12- Fokusoheni të gjithë vëmendjen tuaj në objektin që po vëzhgoni. Kur mendja juaj është e zënë me objektin ku jeni fokusuar, nuk ka vend për mendime negative. Të shtyrë e mendimeve stresuese. Ju mund të praktikoni këtë ecuri të thjeshtë për të kufizuar shqetësimin tuaj.

13- Vëzhgojeni me kujdes shqetësimet tuaja gjatë ditës. Mundohuni të përcaktoni kur ju fillojnë t'ju shqetësojnë mendimet negative.

14- Caktotini vetes detyrë që të merreni me shqetësimet tuaja gjysmë ore, çdo ditë, në të njëjtën

kohë dhe në të njëjtën vend. Cila është periudha juaj e shqetësim-it?

15- Shtyjini mendimet tuaja shqetësuese. Në çdo kohë që ju e ndieni se po filloni të shqetësoheni, shtyjini mendimet tuaja, deri në atë periudhë të ditës, të cilën ju e keni caktuar për t'u marrë me shqetësimet tuaja.

16- Kur në mendjen tuaj të shfaqen mendimet shqetësuese, jashtë periudhës ditore që ju keni caktuar për t'u marrë me to, zëvendësojeni ato. Fokusoni vëmendjen në atë punë që keni në dorë, apo në diçka tjetër përreth. Më e rëndësishmja. Përdoreni periudhën ditore të caktuar, për t'u marrë në mënyrë intensive me shqetësimet tuaja.

17- Detyrat e pakëndshme Sa herë që në mendjen tuaj të shfaqen mendime negative, përfshijuni energjikisht në kryerjen e ndonjë detyre që ju e konsideroni të pakëndshme p.sh. larja e dyshemesë, fshirja e pluhurave, etj.

18- Shmangni mërzitjen e stresin

Studimet e bëra nga Johns Hopkins në vitin 2002, treguan se meshkujt, të cilët zemërohen shpejt apo shfaqin shenja të dukshme mërzie si kundërpërgjigje ndaj stresit janë rreth tre herë më tepër me të prekur nga rreziku i zhvillimit të sëmundjeve të ndryshme të zemrës, në krahasim me meshkujt të cilët paraqesin përgjigje me zemërim më të ulët ndaj stresit. Ata e rrisin rrezikun e tyre rreth 6 herë për të pësuar atak pas moshës 55-vjeçare. Një shpjegim i mundshëm ka të bëjë me lidhjen mes zemërimit dhe presionit të lartë të gjakut, të cilët së bashku shtojnë nivelin e stresit të një individ. Një këshillë: Pranojeni mërzinë si të pashmangshme, pas pak stresi do të rrokulliset poshtë nga supet tuaja. Uluni me

shpinën drejt dhe provoni të qetësoni mendimet tuaja, kjo do t'iu ndihmojë të relaksoheni.

19- Luftoni ankthin Rreth 2 % e popullatës kanë përjetuar një lloj forme të krizës së panikut. Njerëzit me frikë/ankthe të ndryshme (p.sh. agorafobi, frika ndaj insekteve apo mikrobeve), përjetojnë më shumë kriza paniku, sidomos jashtë periudhës ditore që ju keni caktuar për t'u marrë me to, zëvendësojeni ato. Fokusoni vëmendjen në atë punë që keni në dorë, apo në diçka tjetër përreth. Më e rëndësishmja. Përdoreni periudhën ditore të caktuar, për t'u marrë në mënyrë intensive me shqetësimet tuaja. Krizat e panikut zakonisht shfaqen në moshë të re (20-at) dhe femrat janë 2 herë më tepër në rrezik për të shfaqur kriza paniku sesa meshkujt. Zakonisht krizat e panikut ngatërohen me atak zemre gjë që ndikon negativisht në vetëdiagnozën e krizës.

20- Adrenalina, përgjegjëse për ankthin

Një sëmundje fizike e quajtur hypoglycemia është gjendur të jetë shkaktare për kriza paniku. Ata që vuajnë nga hypoglycemia kanë receptorë defektive për substancën insulinë, gjë që nuk lejon kalimin e suksesshëm të sheqerit në membranën e qelizave. Kur niveli i sheqerit në gjak ulet shumë, truri dërgon sinjale alarmi në qendrat hormonale duke i sinjalizuar të prodhojnë adrenalinë, e cila është përgjegjëse për krizat e panikut. Tre janë format e shfaqjes së panikut tek të gjithë njerëzit. Nëse keni përjetuar një formë, nuk është e thënë të mos përjetoni edhe të tjerat, në të tre rastet simptomat janë të kundërta.

Agron Duka i rrëfen të gjitha: Zili për Fatos Nanon, episodi me Olldashin dhe çfarë ka në plan opozita

Agron Duka kryetari i PAA-së, i ngacmuar nga gazetarët e In Tv për mundësinë e një ndryshimi kahu, tha se gjithçka varet nga korrektësia e Bashës në raport me partnerët e koalicionit. Ai, gjithashtu, u shpreh për ruajtjen e votave dhe mundësinë e kandidimit në Durrës. I pyetur nëse ndjente zili për ndonjë politikan, Agron Duka deklaroi se ishte Fatos Nano personi politik për të cilin ndjente zili.


Arsyeja ishte, krahas vlerësimit për qeverisjen, tolerance dhe tejkalimi i inateve personale, ndryshe nga Duka, i cili rrëfeu se i kishte përjetuar sulmet e Berishës dikur. I pyetur për një tjetër ish-kryeminister të majtë si Fino dhe humbjen përballë vëllait, Armando, për kreun e FSHS Duka tha se do ishte surprizuar nëse rezultati do kish qenë ndryshe e jo fitorja e "Mondit". Sa i takon emocioneve personale në politikë, Duka rrëfeu një episod shumë interesant me Sokol Olldashin në një përballje televizive.



Arsyeja ishte, krahas vlerësimit për qeverisjen, tolerance dhe tejkalimi i inateve personale, ndryshe nga Duka, i cili rrëfeu se i kishte përjetuar sulmet e Berishës dikur. I pyetur për një tjetër ish-kryeminister të majtë si Fino dhe humbjen përballë vëllait, Armando, për kreun e FSHS Duka tha se do ishte surprizuar nëse rezultati do kish qenë ndryshe e jo fitorja e "Mondit". Sa i takon emocioneve personale në politikë, Duka rrëfeu një episod shumë interesant me Sokol Olldashin në një përballje televizive.

Vlonjatët gjejnë zgjidhjen për turistët, prezantojnë restorant "Babalja"

Pas heshjes së opozitës për çështjen "Babalja", duket se Albert Veliu ka kush e kujton në këto ditë të vështira për të. Në qytetin e Vlorës, me qëllim thithjen e turistëve është emërtuar një restorant me emrin "Babalja". Duket se emri i ri ka shërbyer që pronari i lokalit të shtojë klientelën. Emri 45-vjeçarit nga Novosela u bë i njohur pas pretendimit se Babalja ka regjistruar një telefonatë për trafik droge me vëllain e ministrit të Brendshëm Fatmir Xhafaj. Veliu trazoi opinionin publik për rreth një muaj.



BULEVARDI POLITIK

Në merrni seriozisht! 😊

Meta le presidencën dhe i bashkohet miqësisë së LSI-së

Presidenti Ilir Meta ka lënë dje, për pak çaste zyrën e tij të presidencës, për të qenë pjesë e gëzimit familjar të deputetit të LSI-së, Lefter Koka. Meta së bashku me Kryemadhin dhe një sërë deputetësh të tjerë të LSI-së, në një tryezë në natyrë, duket se kanë kaluar momente të këndshme mes tyre, ku nuk kanë munguar as muzika dhe ushqimi i mirë. Ka qenë deputeti i LSI në Shkodër, Agron Çela ai që ka ndarë dhe disa foto nga ky takim, ku thotë se solidariteti dhe miqësia e mban bashkë LSI-në. "Solidariteti e miqësia e mban gjithnjë bashkë dhe e bën më të bukur marrëdhënien brenda grupit parlamentar të LSI-së, gjë që u shfaq me shume kolorit e spontanitet në një gëzim familjar të mikut e kolegut tonë Lefter Koka. Në një mjedis fantastik mes gjelbërimit të pemëve e në një vresht të kultivuar mjeshtërisht, u mblodhëm, festuam e gëzuam si në një familje. Faleminderit Teri për respektin që na bëre e kënaqësinë që na dhe, e kështu në gëzime u mbledhshim gjithmonë!", shkruan Çela në postimin e tij.



Spartak Ngjela flet për marrëdhëniet me femrat: Ja pse nuk jam martuar

I ftuar në emisionin e Jonida Vokshit, "Thurje", Ngjela ka rrëfyer për bukurinë femërore dhe se sa i meritojnë meshkujt shqiptarë, femrat shqiptare. Ai po ashtu ka rrëfyer edhe arsyen se përse nuk ka preferuar që të marthohet dhe të lërë trashëgimtarë. "Nuk dua që t'ia injektoj të tjerëve mendimin tim, por shkurt po ju them. Martesa është e mirë, duhet ta marrësh përsipër. Është risk i madh. Janë 2 gjëra, të cilat tipi duhet t'i pranojë, dhe tipi nuk i pranon. Është risku i vazhdimësisë dhe bashkëjetesa e gjatë", e ka shpjeguar Ngjela.




BOTIMI

Ministri i luftës që duhej të mbronte pavarësinë

Rrugëtimi i kujtesës historike Mehmet Pashë Deralla 1843-2018

Me rastin e 175-vjetorit të lindjes së Ministrit të parë të Luftës dhe krijuesit të Ushtrisë së parë Shqiptare, Mehmet Pashë Deralla, Muzeu Historik Kombëtar, Qendra për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Ballkanike Tetovë dhe Lidhja e Diasporës Shqiptare për Maqedoninë organizuan ekspozitën me foto dhe dokumente të pa ekspozuara më parë rreth jetës së Tij publike dhe private. Me rastin e këtij përvjetori u bë edhe promovimi i librit, kushtuar këtij personaliteti të mbrojtjes dhe shpalljes së Pavarësisë Shqiptare. Ishin të pranishëm në organizimin e këtij aktiviteti personalitete të shumta nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia. Ceremoninë e hapjes së ekspozitës e përshëndetën Drejtori i Muzeut Historik Kombëtar, Dr. Dorian Koçi, Kryetari i Lidhjes së Diasporës Shqiptare për Maqedoninë, Xhavit Prespa, kuratori i ekspozitës Arsim Sinani, si edhe pasardhës të Mehmet Pashë Derallës. Në emër të Ministrisë së Mbrojtjes të Shqipërisë ceremoninë e përshëndetoi zv.ministri, Petro Koçi, i cili ndër të tjera tha se: "Është një nder i veçantë për mua që në emër të Ministrisë së Mbrojtjes të marr pjesë në këtë konferencë shkencore kushtuar kësaj figure të rëndësishme të historisë sonë shtetformuese, siç është Mehmet Pashë Deralla. Zgjedhja e Mehmet Pashë Derallës në krye të Ministrisë së Luftës, sot Ministria e Mbrojtjes, nuk ishte një rastësi, por një domosdoshmëri". Sipas tij, ai ishte një personalitet i padiskutueshëm në fushën e vet, një personazh me vlerë si një nga protagonistët e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. "Ministria e Luftës e drejtuar prej tij mori përsipër barrën e madhe historike, misionin e ruajtjes së pavarësisë së vendit dhe të mbrojtjes së qeverisë së parë shqiptare duke mos pasur asnjë strukturë të mirëfilltë ushtarake. Kuptohet që Ministria e Luftës të asaj kohe është shumë larg përfytyrimit që ne kemi sot për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura, por në ato kushte ishte më e mira që mund të bëhej". "Jam krenar të pohoj sot se, Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura vazhdojnë të përçojnë vlerat më të mira të traditës sonë patriotike, të atyre vlerave që



mundësuan formimin e shtetit shqiptar", përfundoi zv. ministri i

Mbrojtjes Petro Koçi. Promovimi i studimit është faza përfundimtare e



lartësimi të figurës së generalit Mehmet Pashë Deralla e ardhur nga një punë e madhe kërkimore dhe disa vjeçare nga personalitete në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Studimi është një përmbledhje kumtesash nga konferenca "102 vjet shtet shqiptar dhe më pas. Çështja shqiptare dhe familja Deralla", të mbajtura në Tetovë në vitin 2014. Por, përveç saj ky botim përmban edhe punime shkencore, dokumente arkivore të pa ekspozuar më parë për publikun. Pra, studimi përbëhet nga 32 punime shkencore, 12 fjalime dhe dokumente arkivore.

Gjatë promovimit të këtij botimi referuan Drejtori i Muzeut Historik Kombëtar, Dr. Dorian Koçi, i

cili ndër të tjera tha se: "Muzeu Historik Kombëtar, si institucioni më i rëndësishëm i memories kombëtare është i privilegjuar të organizojë promovimin e librit "Mehmet Pashë Deralla në 175-vjetorin e lindjes (1843-2018)". Ky promovim zhvillohet në vazhden e aktiviteteve që kemi ndërmarrë në kuadër të 550-vjetorit të vitit të Gjergj Kastriotit Skënderbeut, 140-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe të 110-vjetorit të Kongresit të Manastirit, të cilat janë tri nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e popullit shqiptar. Botimi del si numër special i revistës shkencore ndërkombëtare "Diskutime", e cila tashmë ka fituar një popullaritet të madh në qer-

RIKTHEHET PANAIRI I LIBRIT TË ULQINIT

Mbahet këtë vit Panairi i 18-të i Librit "Ulqini 2018", nga data 3-8 gusht në shtetitoren e Plazhit të Vogël, pranë lokalit "Hollegro". Ky aktivitet organizohet nën kujdesin e Komunës së Ulqinit dhe do të realizohet falë bashkëpunimit të Institutit të Librit dhe të Promocionit me Organizatën Turistike të Ulqinit dhe me Qendrën për Kulturë të Ulqinit, Mali i Zi. Panairi i sivjetshëm realizon vazhdimësinë e traditës së organizimit të kësaj veprimtarie që pritet me shumë interes nga qytetarët e Ulqinit dhe pushuesit, të cilët e kanë shumëfishuar numrin e banorëve të Ulqinit gjatë këtij sezoni. Veç librave nga Shqipëria, Kosova e Shkupi, do të ekspozohen libra e do të marrin pjesë botues edhe nga Mali i Zi e pakicat e tjera kombëtare të kësaj republike. Do të jenë ata që përfaqësohen vazhdimisht në veprimtari të tilla me karakter kulturor kombëtar, që vijnë nga e gjithë

hapësira shqiptare e rajonit tonë dhe që janë nga përfaqësuesit më të rëndësishëm të botimeve shqiptare pas viteve '90. Rreth 50 botues do të jenë të pranishëm gjatë ditëve të Panairit, ose do të dërgojnë botimet e tyre më të mira të përfaqësuara nëpërmjet agjencive të shpërndarjes së librit.

Në Panairin e Librit në Ulqin parashikohet të ekspozohen dhe të

ofrohen letërsi artistike të autorëve shqiptarë e të huaj, por edhe histori, botime enciklopedike, guida turistike, letërsi për fëmijë, fjalorë e metoda për mësimin e shqipës dhe të gjuhëve të huaja, albume e katalogë gjithfarësh etj., për lexuesit ulqinakë dhe pushuesit.

Është traditë e Panairit të Librit në Ulqin që të ketë në çdo edi-

cion të ftuar të veçantë, personalitete nga fusha e kulturës, akademikë, administrata shtetërore apo politika. Kështu, në vitet e mëparshme, shiritin e inaugurimit të kësaj veprimtarie e kanë prerë personalitete të tilla, si Dritëro Agolli, Rexhep Qosja, Ismail Kadare, Fatos Arapi, Fatos Kongoli, Ali Podrimja, Jevren Brković, Luan Starova, Zuvdi Hoxhiç, Sreten Asanović, Aleksandër Stipčević, ministri i Kulturës të Shqipërisë e të Malit të Zi, akademikë e parlamentarë të të dyja vendeve, si dhe ish-presidenti i Shqipërisë Rexhep Meidani. Ndërsa në 5-vjetorin e këtij Panairi, prenjë shiritin e tij presidentët e dy vendeve, Alfred Moisiu i Shqipërisë dhe Filip Vujanović i Malit të Zi.

Në ceremoninë e hapjes, ditën e premtë, më 3 gusht, ora 20:00, do të jenë të pranishëm shkrimtari dhe ish-politikani Namik Dokle, si dhe shkrimtari dhe ish-ministri i Kulturës së Malit të Zi, Pavle Goranović.

FTE SË

CEREMONIA E ÇELJES
E PREMTE - 3 GUSHT - ORA 20:00



Ju ftojme të merrni pjesë në Panairin e 18-të të Librit "Ulqini 2018" 3-8 gusht

PLAZHI I VOGËL (pranë lokalit Hollegro)

DEBATI

“Shembja e Teatrit Kombëtar të viteve ’30 është sakrilegj”



thullin mbarëshqiptar. Në këtë botim janë përmbledhur aktet e konferencës shkencore ‘102 vjet shtet shqiptar e më pastaj. Çështja shqiptare dhe Derallajt’, që është mbajtur 5 vjet më parë në Tetovë. Referuesit e kumtesave hedhin dritë me fakte të reja mbi figurën e shquar të Gjeneral Mehmet Pashë Derallës, i cili ka hyrë në histori si ministri i parë i Luftës së Shtetit Shqiptar. Mehmet Pashë Deralla ka hyrë në memorien historike të shqiptarëve si gjenerali shtatlartë që qëndronte në ballkon në krah të Ismail Qemalit në përvjetorin e parë të ngritjes së flamurit më 1913. “Në referuesit e shumtë që kanë dhënë kontributin e tyre për të ndriçuar këtë figurë të ndritur të kombit shqiptar mund të përmendim: Arsim Sinani, Afrim Krasniqi, Bujar Dugolli, Darling Ismail Vllora, Ruki Kondaj, Ibrahim Gashi, Romeo Gurakuqi, Zaho Golemi, Ermir Nika, Qerim Lita, Proletar Hasani, Bernard Zotaj, Asllan Zemani, Ilir Zylfiu, Haxhi Ademi, Ndrim Mehmeti, Skënder Lutfiu, Berat Murina, Man Poga, Kasriot Veselaj, Izet Abdylit etj”, përfundoi drejtori Koçi. Rreth kronologjisë jetësore të Mehmet Pashë Derallës foli Prof. Zaho Golemi. Gjithashtu, përshëndetën aktivitetin edhe Kryetari i Lidhjes së Diasporës Shqiptare për Maqedoninë, Xhavit Prespa, dhe z. Martin Berishaj. E mbylli aktivitetin Arsim Sinani, kryetar i Qendrës për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Ballkanike Tetovë, i cili falënderoi drejtorin e Muzeut Historik Kombëtar, Dr. Dorian Koçi, për organizimin e këtij aktiviteti si edhe bëri një prolog për Derallajt.

Në fund të këtij aktiviteti, me një ceremoni të veçantë nga burrat e Gradecit, Muzeut Historik Kombëtar ju dhurua flamuri i familjes së Derallajve, si edhe një dosje më burime arkivore nga Stambolli mbi Mehmet Pashë Derallën.

Patrizio Ranieri Ciu është regjisor e autor italo-shqiptar, drejtor artistik i kompanisë teatrore Fabbrica Vojtyla, me seli në Kazerta, Itali. Këtë të martë, ishte në Tiranë në protestën për mbrojtjen e teatrit bashkë me artistët italianë të “Compagnia della Città & Fabbrica Vojtyla” ai u bashkua kështu me shqiptarët që kërkojnë reflektim mbi rrezikun e zhdukjes së historisë dhe kujtesës, në një kryeqytet që ka prirjen të mos ruajë më asnjë dëshmi të rrugëtim-it të tij kulturor. Thirrjes së zjarrtë të atyre që përqipen të bindin Presidentin e Republikës, Ilir Meta, që ka vetëm një javë kohë për hedhur poshtë ligjin, artistët e “Fabbrica Vojtyla” i përgjigjen me një ndërhyrje me tinguj e fjalë, para Teatrit Kombëtar në Tiranë, të nxjerra nga “Monodialogjet” e autorit dhe regjisorit italo-shqiptar, Patrizio Ranieri Ciu, që historikisht ka dhënë ndihmesë për procesin e rilindjes së identitetit intelektual shqiptar.

Në fjalën e mbajtur para protestuesve që prej më shumë se 40 ditësh ruajnë teatrin, Ranieri pyeti: “Përse një ditë i Kalifatit Omayyadit vlen sot 5 milionë euro? Sepse u shtyp në Damask në vitin 723 pas Krishtit dhe kështu hyri në Histori me H të madhe. Gjithçka që ka karakter unik dhe që simbolizon përmbajtje e personazhe që kanë lënë gjurmë, në një mënyrë ose një tjetër, në historinë e një vendi, fiton një vlerë të pamatë, jo vetëm për atë vend, por për të gjithë njerëzimin, i cili ka të drejtën dhe detyrën të njohë origjinën e atij vendi, për të kuptuar mënyrën se si do të jetë ai në të ardhmen”.


Patrizio Ranieri tha se “tani, të fshih me një goditje të vetme, një ndërtesë që ka parë ato që Teatri Kombëtar i Shqipërisë, ka ditur dhe ka mundur të verë në skenë, është një sakrilegj! Duhet të bëhemi të vetëdijshëm se, sado të na duket paradoks, dërrasat e skenës janë ‘të gjalla’, njësoj si varret e familjarëve. Dhe këtë e them i frymëzuar nga një faqe e mrekullueshme e Kadaresë me këtë temë”. Ai shtoi se të nderosh atë që ka kaluar, të kujton nga vjen dhe të sqaron se ku mund të shkosh.

“E pra, ky është një teatër, me ose pa aktorë. E kupton sapo hyn brenda. Përfshihesh nga një atmosferë, që asnjë pallat kongresesh në botë nuk mund të të bëjë ta ndjesh. E nëse vendos duart në dërrasat që formojnë skenën, ndjen një energji që të flet për origjinën, për intelektin e shumë shqiptarëve që e kanë jetuar, ndërsa rrezaton një forcë, aty, të gatshme për të ndihmuar djemtë e rinj, të talentuar e intelektualë, që do ta jetojnë” thekson Ranieri Ciu. Për të, mirë se të vijnë teatrit e rinj, të përfshirë në pro-



Gjergj Bojaxhi dhe Afrim Krasniqi me ambasadorin Romana Vlahutin

Regjisori Patrizio Ranieri Ciu në mbrojtje të Teatrit Kombëtar, Forumi i Trashëgimisë takon Vlahutin



Patrizio Ranieri Ciu

jektje perfekte, futuriste dhe të avangardës, por është e pakuptueshme si dhe pse, kjo duhet të ndodhë duke zhdukur një ndërtesë që i ka takuar jo vendit, jo banaliteteve të përditshme, por mendimeve të mëdha universale. “Është njësoj sikur në Romë të vendosej të shembjej Koloseu, për të bërë një stadium ultramodern. Nuk mund të thuash se Teatri Kombëtar nuk është as Koloseu, as Teatri La Scala. As politikanët

shqiptarë nuk janë John apo Robert Kennedy. Madje, po të flasim për shqiptarë të famshëm, kushe-di çfarë do të thoshte sot Fan Noli? Eh, duke ia njohur mençurinë dhe gjykimin, nuk e di pse, por e para pyetje që besoj se do t'i bënte, atij që ngul këmbë tek nevoja për këtë shembje absurde, është: përse nuk mund të bashkëjetojnë të dyja?”, pyet regjisori e autori italian. Pastaj, para të pranishmëve, ai do të shtonte... “a nuk do të ishte më

mirë, që këtë megaprojekt ta bënim më tutje, atje ku është një lloj ndërtesë ‘përkujtimore’? Dhe atij që do t’ia kthente se edhe ajo është histori, me siguri do t’i përgjigjej se kur ajo histori ka rezultuar në fund kaq negative, kjo tjetra, fundja nuk është aq e keqe sa për ta zhdukur”.

Kështu, simbolet e Napolit, rajonit të Kampanias dhe Italisë zbarkuar në Tiranë me Pulcinella-n, si përfaqësuese të Commedia dell’Arte, fillesa e teatrit, aktori i zi, si zëdhënës i avangardave të reja dhe zëri i Jugut, me këngët tradicionale dhe pjesët moderne të papublikuara, të gjithë gati për të shprehur një sekuecencë kujtese të artit në kohë, një shkrirje mes së shkuarës dhe të tashmes, si metaforë e Teatrit Kombëtar, që është dhe duhet të jetë sipas tyre gjithmonë zemra e muzikës, dan-sit dhe teatrit shqiptar.

FORUMI

Një përfaqësi e Forumit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore u takua dhe me kreun e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë, Romana Vlahutin dhe Mario Mariani, drejtesit i Departamentit të Bashkëpunimit, për të diskutuar mbi çështjen e Teatrit Kombëtar. Vetë Forumi informon se Gjergj Bojaxhi dhe Afrim Krasniqi shprehën qëndrimin e Forumit për ruajtjen e godinës historike të Teatrit Kombëtar si dhe kërkuan angazhimin e mëtejshëm të Bashkimit Evropian për të siguruar transparencë mbi veprimet ligjore në këtë drejtim.

Sipas faqes së Forumit, Kryediplomatja e Bashkimit Evropian në Tiranë falënderoi Forumin për kontributin e dhënë për këtë çështje si dhe për mbrojtjen e trashëgimisë në përgjithësi. Gjatë takimit u garantua se çështja e teatrit, për sa i përket procedurave ligjore të ndjekura në respektim të marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit me Bashkimin Evropian, po ndiqet me mjaft vëmendje nga Bruxeli. Ka një komunikim me autoritet shqiptare dhe do të mbahet qëndrimi i duhur zyrtar në ditët në vijim.

Gjithçka që ka karakter unik dhe që simbolizon përmbajtje e personazhe që kanë lënë gjurmë, në një mënyrë ose një tjetër, në historinë e një vendi, fiton një vlerë të pamatë, jo vetëm për atë vend, por për të gjithë njerëzimin, i cili ka të drejtën dhe detyrën të njohë origjinën e atij vendi, për të kuptuar mënyrën se si do të jetë ai në të ardhmen

Opinion i Ditës

Loja e Hashim Thaçit për një sakrificë të rëndë për Kosovën

Nga Agustin Palokaj

(Vijon nga faqja 1)

... dhe me të drejtë. Pakoja e Ahtisaarit, siç quhet "propozimi gjithëpërfshirës për statusin e Kosovës", duke marrë parasysh rrethanat specifike, si të kaluarën ashtu edhe realitetin në terren, kishte vendosur themelet për krijimin e shtetit të Kosovës nën mbikëqyrje ndërkombëtare dhe me garanci të veçanta për komunitetin serb dhe trashëgiminë e tyre kulturore dhe fetare. Ky dokument kishte shërbyer edhe për hartimin e Kushtetutës së Kosovës.

Pse me të drejtë quhej "kompromis" Pakoja e Ahtisaarit? Sepse ajo i jepte mundësi bashkësisë ndërkombëtare që pa marrë obligime ndaj Kosovës dhe qytetarëve të saj, pa nevojë që të jetë përgjegjëse për veprimet e veta në territorin e Kosovës, të ketë rolin shpesh edhe vendimtar në jetën politike, ligjore dhe gjyqësore.

Për shembull, sipas kësaj Pakte, BE-ja mori aq shumë rol në Kosovë e asnjëherë nuk dha përgjegjësi as për dështimet e EULEX-it e nga aspekti politik as që përfillti propozimin e Ahtisaarit për statusin e Kosovës, sepse BE-ja asnjëherë nuk e mbështeti këtë propozim e as sot e pranon formalisht Kosovën si shtet të pavarur të shpallur sipas kësaj pakte. Ishte kompromisi edhe për shkak se në bazë të këtij propozimi serbëve të Kosovës iu dha mundësia që të mund të bllokojnë çfarëdo ndryshimi ligjor apo kushtetues në Kosovë që ka rëndësi. Kjo shihet tash në shembullin e FSK-së kur ata bllokojnë ndryshimet që do të bënin këtë formacion ushtri, por edhe në çfarëdo ndryshimi të mundshëm kushtetues.

Quhet kompromis, sepse nuk lejoi që Kosova të bashkohet me ndonjë shtet tjetër apo pjesë të territorit të një shteti tjetër. Për ata që mbështesin idenë e bashkimit kombëtar kjo pa dyshim ishte një kompromis i madh. Quhet kompromis, sepse Kishën ortodokse serbe e bën si shtet me vete në territorin e Kosovës. E krejt këto mundësi që iu dhanë serbëve të Kosovës, për të siguruar mbrojtjen e tyre, me dialogun në Bruksel, u shndërruan në fuqi të Beogradit, i cili mori nën kontroll jetën politike, shoqërore, kulturore dhe çfarëdo tjetër të serbëve të Kosovës e me këtë edhe rol kyç në zhvillimet e brendshme politike të Kosovës.

Pra, me Pakon e Ahtisaarit Kosova nuk i kishte fituar "të gjitha" siç pretendon Beogradi tash e sa vjet. Me Pakon e Ahtisaarit Kosova ishte bërë shtet, por me vërshtirë të funksionimit. Pas ndarjes formale territoriale Kosova edhe me Pakon e Ahtisaarit i ngjan shumë Bosnjë-Hercegovinës.



Kosova kishte pranuar Pakon e Ahtisaarit si kompromis për shkak se kjo ishte mundësia e vetme që të zgjidhej statusi i saj dhe të shpalle çfarëdo pavarësisë.

Dhe prej ditës kur Kosova kishte shpallur Pavarësinë të tjerët kishin nisur rrënimin e parimeve të Ahtisaarit. BE-ja këtu ka fajin kryesor, sepse e para dështoi që të mbështeste këtë propozim, ani pse gjatë gjithë procesit të negociatave për statusin e Kosovës me shumë kujdes kishte për rolin dhe nevojat e BE-së sesa të Kosovës si shtet. Kjo edhe sot vazhdon të dëshmohet përmes "qëndrimit neutral ndaj statusit" që është një formë e zbutur e kundërshtimit të statusit. Sepse realisht nuk mund të jesh neutral ndaj statusit të një shteti, nuk mund ta konsiderosh një territor edhe si shtet të pavarur, edhe si pjesë e një shteti tjetër ose si territor pa status. "Status neutral", në fakt, është "status negativ".

BE-ja, aq më tepër, për vite e ka shndërruar këtë mohim të statusit të Kosovës në një argument të fortë për rolin e saj në rajonin e Ballkanit. Këtë e kanë thënë privatisht dhe vazhdojnë ta thonë njerëzit kryesorë në Bruksel që janë të angazhuar në "lehtësimin e dialogut". Për ta është mirë që Kosovën e kanë njohur shumica e shteteve të BE-së, sepse këtë e përdorin në biseda me shqiptarët e Kosovës për t'ua lënë përshlytjen se çështja e statusit është punë e kryer, por është mirë se 5 shtete nuk e kanë njohur, sepse mund t'i thonë Beogradit se BE-ja është neutrale ndaj

statusit.

Pos Pakos të Ahtisaarit, të cilën BE-ja asnjëherë nuk e mbështeti për shkak të mungesës së unitetit dhe mungesës së vullnetit të shumicës së shteteve anëtare dhe të institucioneve në Bruksel që të ndërtohet ky unitet, Kosova kishte edhe një rast që nuk e shfrytëzoi: Mendimin e GJND-së se shpallja e Pavarësisë së Kosovës nuk shkel normat e së drejtës ndërkombëtare dhe, që është po aq e rëndësishme, shpallja e Pavarësisë nuk shkel as Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Pra, kur Beogradi, Moskë apo Madridi bazohen në Rezolutën 1244, atyre nuk u thuhet se GJND-ja, Gjykatë e OKB-së, e ka dhënë mendimin se ajo rezolutë nuk ishte shkelur. Madje nga vetë ajo rezolutë mund të burrojë edhe procesi i negociatave që nxori Pakon e Ahtisaarit dhe si pasojë shpalljen e Pavarësisë.

Por tash Kosova ka pranuar përmes dialogut se duhet t'i jepet Beogradit "diçka më shumë se Ahtisaari". Me këtë është pranuar logjika e Serbisë se "Kosova ka fituar gjithçka e serbët asgjë", sikur kjo të kishte qenë një garë. E tash jo për ta bërë Beogradin fitues, por për ta bërë edhe Kosovën "humbëse" duhet dhënë diçka më shumë.

Ajo "më shumë" duket se do të jetë krijimi i një "Republika Sërpskas" në Kosovë, apo formalizim i ndarjes së Kosovës, qoftë në mënyrë territoriale apo edhe institucionale. Kjo mund të shtet në fillim si kompromis e pastaj grad-

ualisht do të kërkohej diçka më shumë", sepse në praktikë nuk do të jetë funksionale, siç nuk është sot funksionale Bosnjë-Hercegovina sipas Marrëveshjes së Daytonit dhe serbët gjithnjë e më shumë kërkojnë ndarje nga ky shtet. Kështu, në një të ardhme mund të kërkohej që edhe serbët e Kosovës të ndahen nga Kosova.

Pa marrë parasysh se çfarë thonë apo çfarë nuk thonë diplomatët ndërkombëtarë rreth opinionit të ndarjes së Kosovës, ekziston ende një kundërshtim i madh në bashkësinë ndërkombëtare ndaj kësaj ideje. Jo për shkak se u dhimbset Kosova, por për shkak se nuk duan zgjidhje, e cila do ta destabilizonte rajonin. Të gjithë duan që një marrëveshje e ardhshme për normalizimin gjithëpërfshirës të raporteve të Kosovës dhe Serbisë të ketë ndikim pozitiv afatgjatë në stabilitetin e rajonit. E ndarja kurrsesi nuk mund të jetë zgjidhje, e cila do ta destabilizonte rajonin, por do të shkaktonte të kundërtën, do të hapte Kutinë e Pandorës dhe do ta destabilizonte edhe më tej.

Presidentët e Kosovës dhe Serbisë ishin në Bruksel edhe për një takim. Të dy thanë se bisedimet kanë qenë të vështira. Por duket se po afrohen në një thënie: se "zgjidhja do të jetë e dhimbshme". Deri tash kështu thoshte shpesh presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, e tash po e thotë edhe ai i Kosovës, Hashim Thaçi. Asnjëri nuk po e sqaron se çka mendojnë me "zgjidhje të dhimbshme".

Si të pajtohen thirrjet e presidentit Thaçi dhe grupit të tij me Limajn, Haradinajn, Veselin e Pacollin për t'u bashkuar për një fitore të radhës së Kosovës në dialog me paralajmërimet se zgjidhja do të jetë e dhimbshme për Kosovën. Fitorja e dhimbshme ekziston si fenomen dhe ajo quhet "Fitorja e Pirros" sipas mbretit epirot, fitoret e së cilit kundër romakëve çonin në vetëshkatërim "dhe ca fitore të tilla dhe do të zhdukemi", është thënia me të cilën më së shpeshti ilustron fitorja e Pirros.

Në vjeshtë do të ketë vazhdim të dialogut, i cili thuhet se tash ka hyrë në "fazën finale". Një gjë ka sqaruar takimi i fundit në Bruksel: ia ka dhënë BE-së një dëshmi se Hashim Thaçi në Kosovë është i fuqishëm. Deri tash mendohej se Thaçi në Kosovë nuk e ka fuqinë e Vuçiqit në Serbi dhe kjo shihet si pengesë në dialog sepse, edhe nëse Thaçi do të pranonte kompromise në Bruksel, ai nuk do të mund të zbatonte në Kosovë. Tash Thaçi i mori me vete Ramush Haradinajn, Fatmir Limajn e Kadri Veselin. Katër këta janë ish-zyrtarë kryesorë të UÇK-së që kanë rolin kryesor në partitë politike në Kosovë. Kush e ka mbështetur dhe tyre është shumë i fortë edhe në Kosovë dhe jashtë saj. Krahas atyre në delegacion ishte edhe Behxhet Pacolli. President i ardhshëm i Kosovës nëse e mbajnë flajën katër burrat e tjerë. Me ta ishte edhe një zëvendëskryeministër tjetër, Nardan Gashi, për të cilin thonë se është ndërmjetësues mes të gjithë këtyre dhe po ashtu edhe të personave tjerë politikë dhe jopolitikë që ndajnë pushtetin real në Kosovë.

Thaçi, nëse është përt'u besuar burimeve në Bruksel, asnjë prej anëtarëve tjerë të delegacionit të Kosovës që ishte në Bruksel nuk ishin ftuar nga BE-ja. "Vetë Kosova vendos se kush do të jetë në delegacion të saj"-thoshin në BE, ndërsa në dialog me Serbinë ishte vetëm presidenti Thaçi. Por Thaçi i kishte marrë me vete për të treguar se i ka prapa fuqishëm, pa marrë parasysh se çfarë flasin kohë pas kohe ata në Kosovë. Dhe kjo duket të jetë e vërteta.

Çfarë mendojnë LDK-ja dhe Vetëvendosje pak ka rëndësi. Vetëvendosje tashmë është e ndarë dhe, nëse do të ketë nevojë, nuk do të jetë shumë e vështirë që të përcahet edhe LDK-ja. Edhe ashtu në atë parti ende ka shumë njerëz që mezi presin t'i afrohen pushtetit. Historia na mëson mirë se sa "të qëndrueshme" janë parimet në këtë parti. Me apo pa ta, Kosova do të bëjë kompromise të reja dhe ndoshta edhe një marrëveshje historike me Serbinë. Çfarëdo që të bëjnë ata që sot janë në pushtet, do të mbejt obligim i përhershëm i Kosovës kushdo që të vijë në pushtet në të ardhmen./ **Koha Ditore**

Opinioni *i* Ditës

Si u shpenzuan 20 miliardë lekë për ndërtim rrugësh vitin e kaluar

Nga Gjergj Erebara

(vijon nga faqja 1)

... e rrugëve të reja. Sipas publikimeve të Ramës, gjatë viteve të ardhshme, në vendin tonë pritet të ndërtohen disa rrugë të rëndësishme, si Rruga e Arbrit që lidh Tiranën me zonën e Dibrës, një segment 21 kilometra autostradë për të lidhur autostradën ekzistuese Tiranë-Durrës me korridorin verijug në vendin e quajtur Thumanë, apo një rrugë e re me dy korsi që duhet të lidhë segmentin ekzistues Levan Tepelenë me qytetin e Sarandës duke dubluar dhe shkurtuar rrugën ekzistuese që kalon nga Qafa e Muzinës.

Por ndërsa projektet e reja janë të shumta, pyetja që ngrenë shumë shqiptarë është: çfarë është bërë me paratë publike të ndërtimit të rrugëve gjatë viteve të shkuara?

Shqipëria pati një fond investimesh publike prej 68 miliardë lekësh (527 milionë eurosh) gjatë vitit 2017. Fondi i investimeve ka qenë në përmasa të tilla përgjatë të pesë viteve të fundit, por objektet e realizuara me këto shpenzime në rëndësi e mbi 2 miliardë eurove janë të vështira për t'u parë.

Një raport i përgatitur nga qeveria për Kuvendin e Shqipërisë në kuadër të "projektit gjatë vitit miratim dhe buxhetit faktik", i cili po diskutohet aktualisht, jep disa të dhëna se çfarë është bërë me këtë fond investimi. Raporti është publikuar në faqen e internetit të Kuvendit [link]. Ministrinë e ndryshme tregojnë njëra pas tjetrës me një gjuhë hiperpropagandistike dhe jo shumë të kuptueshme se çfarë kanë bërë.

Ministria e Infrastrukturasë dhe Energjisë thotë se në programin e saj të transportit rrugor fondi i përgjithshëm i investimeve të realizuara ka qenë 12.1 miliardë lekë ose afërsisht 93 milionë euro me burime të brendshme. Këtyre u shtohen edhe 9.2 miliardë lekë investime me kredi të huaja për një total prej 21.3 miliardë lekësh. Këto janë fondet e përdorura si për ndërtim rrugësh, ashtu edhe për mirëmbajtje.

Raporti nis me fjalë të mëdha: "Në programin "Transporti Rrugor" është realizuar objektivi madhor i forcimit dhe integritimit me rrjetin rajonal TEN-T, përmes dyfishimit të numrit të lidhjeve ndërkombëtare tokësore me Kosovën, Maqedoninë, Greqinë dhe Malin e Zi", shkruhet aty.

Më pas vijohet me punët fizike të realizuara. Programi i rrugëve të tipit A2, rrugë me katër korsi, me trotuare dhe me ndriçim janë shpenzuar gjithsej 4.8 miliardë lekë (rreth 36 milionë euro) dhe sipas raportit, me këto para janë realizuar 4.53 kilometra rrugë. Nga këto, 1.77 km janë "rrugë me katër korsi 2x2" ndërsa 2.76 KM janë rrugë me katër korsi 2x2 me tro-



tuare dhe me ndriçim. Kostoja mesatare e ndërtimit të këtyre rrugëve sipas të dhënave të mësipërme rezultojnë rreth 1 miliardë lekë për kilometër (8.2 milionë euro).

Sipas raportit, me këto para janë realizuar disa projekte si: "By pass Plepa-Kavajë-Rrogzhinë, nga loti 7 deri në lotin 11", "Rruga Kukës-Morinë Loti 1, dublimi", "Vendosja e mbikalimeve për këmbësorë në aksin Plepa-Kavajë-Rrogzhinë".

Po me këto para janë realizuar sipas qeverisë edhe projektet e mëposhtme:

"Unaza e Re e Tiranës, segmenti Komuna e Parisit - Rruga e Kavajës", "Rruga e Porto Romanos, Durrës Loti 1", "Nyja lidhëse e rrugës Milot-Lezhë, Rrëshen, Thumanë", "Unaza e jashtme Tiranë, pjesa verilindore", "Rikonstruktion segmenti rrugor Kodër-Kamëz Tapizë...etj".

Qeveria thotë se ka shpenzuar edhe 397 milionë lekë për ndërtimin e rrugëve të tipit B1, për të cilat thotë se janë rrugë me dy korsi. Gjatësia e përbashkët e rrugëve të këtij lloji është 1.91 kilometra me një kosto mesatare prej 208 milionë lekësh për kilometër (1.6 milionë euro). Qeveria rendit katër segmente rrugore ku janë ndërtuar së bashku 1.91 kilometra me këto para: "Rruga Lushnjë-Berat, loti2+shtesë punimesh, loti 3 + shtesë punimesh", "Rruga e Arbrit loti2", "Rruga Kardhiq-Delvinë loti1, loti 2, loti3" dhe "Rruga Milot-F.Rrugë (dublimi i superstradës) loti3".

Programi tjetër i ndërtimit të rrugëve është ai i rrugëve të llojit C2, për të cilat qeveria thotë se janë "me dy korsi". Në këtë program janë shpenzuar 1.55 miliardë lekë për 3.94 kilometra rrugë me një mesatare prej afro 393 milionë lekë për kilometër ose 3 milionë euro. Qeveria rendit shtatë segmente rrugore ku është punuar me këto para: "Rruga kanali i Cukës-Butrint loti1", "Rruga mbingritja e Viroit dhe hyrja e qytetit Gjirokastër", "Ndërtimi i aksit Skrapar-Përmet, loti1", "Ndërtim rrugët paralele superstrada Tiranë - Vorë krahu i majtë (vazhdimi)+shtesë kontrate", "Rifreskimi i sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare", "Ndërtim mbrojtja lumi km 16+200 aksit rrugor Elbasan-Librazhd + shtesë punimesh" dhe "Ndërtim mbrojtja lumi km 9+500 rruga e re Milot-Skuraj". Duke qenë se në të gjitha këto gjatësi segmente rrugore janë ndërtuar gjithsej 3.94 kilometra rrugë, atëherë kjo do të thotë se në secilin prej projekteve qeveria ka ndërtuar 0.65 kilometra rrugë.

Programi tjetër i rrugëve kombëtare me financim të brendshëm është "Rikonstrukcioni i Rrugëve". Këtu qeveria thotë se ka shpenzuar 3.8 miliardë lekë për sistemin dhe asfaltimin e 37 kilometrave rrugë, me një kosto mesatare prej 100 milionë lekësh për kilometër ose 780 mijë eurosh. Qeveria rendit tri segmente rrugore ku është punuar me këto

para dhe për të cilat thotë se "punimet po vijojnë": "Riveshje dhe sistemim asfaltim Elbasan-Banjë loti1, loti2, loti3", "Sistemim asfaltim rruga Tri Urat - Leskovik" dhe "Sistemim asfaltim rrugët lidhëse me bregdetin (Llogara-Sarandë) loti1+shtesë punimesh".

Përveç fondeve të brendshme të buxhetit, sektori i rrugëve merr financime edhe nga kreditë jashtë vendit. Për këtë, relacioni i buxhetit të shtetit nuk prononohet, por një raport i Ministrisë së Infrastrukturasë dhe Energjisë thotë se financimet totale gjatë vitit 2017 kanë qenë 9.2 miliardë lekë. Për rrugët e tipit A (autostradë me katër korsi), raporti thotë se plani i vitit 2017 është realizuar në masën 131% të planit, për një total prej 5.5 miliardë lekësh (42 milionë euro) me të cilat janë realizuar 0.9 kilometra rrugë.

Edhe për rrugët e tipit B plani është tejkaluar, sipas raportit të ministrisë. Ndërsa ishin planifikuar të ndërtohejshin 5.4 kilometra rrugë, janë ndërtuar 5.9 kilometra me një shpenzim total prej 3.3 miliardë lekësh (rreth 25 milionë euro) me një kosto mesatare prej 600 milionë lekësh për kilometër.

Në total, raporti thotë se janë ndërtuar rreth 10 kilometra rrugë të llojeve të ndryshme me financim të brendshëm dhe 18.9 kilometra rrugë me financim të huaj. Me të 21 miliardë lekë të shpenzuara raportohet të jenë mirëmbajtur e asfaltuar edhe 37 kilometra rrugë. **Reporter.al**

HOROSKOPI

DASHI

Frika psikologjike mund t'ju dëmtojë. Mendimet pozitive do t'ju mbajnë të fortë. Personaliteti juaj do t'ju ndihmojë të bëni disa miq të rinj. Idetë e reja do të ishin produktive. Sot mund të bëni ndryshime në minutën e fundit.

DEMI

Emocionet do të jenë të larta për shenjë tuaj. Sjellja juaj do të ngatërojë njerëzit që kenë përthet. Vendimet e guximshme lidhur me investimet duhet të bëhen në një ditë tjetër. Një surprizë nga i dashuri juaj do të ndryshojë ditën tuaj.

BINJAKET

Qëndroni të qetë sot. Është parashikuar një rritje e lehtë e të ardhurave nga investimet e kaluara. Nëse planifikoni të keni një festë, atëherë fitoni edhe miqtë tuaj më të mirë. Ju do të jeni në një gjendje shpirtërore të mirë.

GAFORJA

Personat që kanë probleme me presionin e gjakut duhet të bëjnë më shumë kujdes. I dashuri juaj do të kërkojë përkushtim. Shëndeti i bashkëshortit tuaj mund t'ju mbajë të shqetësuar. Sipas yjeve, kjo gjë do të jetë kalimtare.

LUANI

Shëndeti kërkon njëfarë vëmendjeje. Merrni ca kohë për t'u marrë me problemet e fëmijëve tuaj. Sot ju nuk do të jeni në gjendje t'i shprehni ndjenjat tuaja të dashurit. Ditë e shkëlqyer për funksionet sociale dhe fetare.

VIRGJERESHA

Këshillat e një miku do t'ju inkurajojnë të përmirësoni shëndetin tuaj. Të gjitha angazhimet dhe transakcionet financiare duhet të trajtohen me kujdes. Anëtarët e familjes juaj dashuri dhe kujdes. Është dita e duhur për performancë të lartë në punë.

PESHORJA

Disa anëtarë të familjes mund t'ju irritojnë me sjelljen e tyre. Por situata nuk mund të dalë jashtë kontrollit. Mos harroni se çfarë nuk mund të shërohet duhet të durohet. Ata që dashurojnë artin dhe teatrin do të gjejnë disa mundësi të reja.

AKREPI

Shëndeti ka të ngjarë t'ju pengojë në aktivitetet e ditës. Investimet e bëra sot do të përmirësojnë prosperitetin tuaj dhe sigurinë financiare. Anëtarët e familjes do të mbajnë një vend të veçantë në jetën tuaj.

SHIGJETARI

Ndjenja e pasigurisë mund të shkaktojë probleme. Përmirësimi i financave do ta bëjë atë të përshatshme për ju të pagani detyrimet dhe faturat. Do të ketë një zhvillim të rëndësishëm në frontin tuaj personal, i cili do të sjellë gëzim për ju dhe gjithë familjen tuaj.

BRICJAPI

Mos e neglizhoni shëndetin tuaj dhe bëni kujdes me pijet alkoolike. Marrëdhënia juaj romantike do të ketë probleme sot. Ditë e shkëlqyer për t'u fokusuar te problemet tuaja shpirtërore. Shmangni debatet me personin e zemrës.

UJORI

Cështjet e taksave dhe sigurimeve do të duhet të kenë një vëmendje më të madhe. Ju do të ndiheni më të pasurit në botë, pasi gjysma juaj më e mirë do t'ju trajtojë si numri i njëjtë. Shijojeni në maksimum këtë ditë.

PESHQIT

Sot do të dëgjoni muzikën e dashurisë. Nga fillimi në fund, dita do të vazhdojë t'ju bëjë të ndiheni energjike në çdo aspekt të jetës. Përfillon për të shprehur ndjenjat tuaja.

Pasojat e zjarrit në vendin fqinj, të plagosurit luftojnë për jetën. Humbën jetën 24 fëmijë

Apokalips zjarri, 81 të vdekur në Greqi

Ambasada e Shqipërisë në Athinë: 3 shqiptarë të plagosur, 1 rëndë

Zjarri, që deri tani ka marrë 81 jetë njerëz, ndërsa qindra të tjerë vijojnë të jenë të zhdukur, dhe shkatërroi qindra shtëpi e makina në Atikën Juglindore, nisi të hënën pasdite nga Dao Penteli, disa kilometra larg nga Kallitechnoupolis.

Për shkak të temperaturave të larta, erës së fortë dhe mungesës së ndërhyrjes, flakët gjigande u përhapën me shpejtësi, duke shkuar në Neo Voutza, deri në anën tjetër të Maratonës në Mati, kjo e fundit edhe zona më e goditur nga zjarri. 'Zougl.gr' shkoi në vatrën ku shpërtheu zjarri, ku gjurmët e dëmeve janë ende të freskëta. Në pamjet e publikuara shihen banesa të djegura, si dhe shumë automjete të shkruvuara.

Një shqiptar që ndodhet mes të plagosurve nga zjarret masive që përfshinë Greqinë, po lufton me jetën, ndërkohë dy të tjerë janë jashtë rrezikut.

Lajmi është bërë i ditur nga ambasada shqiptare në Athinë. Kjo e fundit përmes një njoftimi në 'Facebook' thekson se shqiptari i minoritetit grek ndodhet në spitalin Evangelismos. Ndërkohë dy shqiptarë të plagosur banojnë në zonën e Matit. Sakaq, nga zjarret janë shkatëruar edhe dëmet tek banesat e shqiptarëve, të cilët janë strehuar përkohësisht në një kamp pushimi.

"Në vijim të njoftimeve tona mbi situatën pas zjarreve shkatërruese në rajonin e Atikës, ambasada ka vijuar gjatë ditës së sotme inspektime në terren nga ku rezultoi se:

Në zonën e Matit raportohet për dy shtetas shqiptarë të lënduar lehtë në gjendje të mirë shëndetësore. Ndërkohë, për sa i përket pjesës tjetër të komunitetit raportohet se janë djegur banesat ku jetonin disa prej tyre, si dhe disa automjete personale. Banorët e prekur janë transferuar përkohësisht në një kamp pushimi të zonës, i cili është kthyer në strehë banimi të përkohshme.

Në zonën e Rafinës raportohet një shtetas shqiptar i minoritetit grek që ndodhet në gjendje të rëndë në spitalin Evangelismos, ndërsa familjarët e tij gëzojnë shëndet të plotë.

Për zonat e tjera të prekura më së shumti nga zjarri, si Kokkino Limanaki dhe Ano Voutsa, ambasada vazhdon të jetë në kontakt të drejtpërdrejtë me autoritetet greke për të marrë informacione në vijim.



Ripërsërisim se për çdo informacion ose nevojë për ndihmë mund të na kontaktoni në 24 orë në nr. +306941658183", thuhet në njoftimin e ambasadës.

Deri më tani 81 persona kanë ndërruar jetë nga zjarret, ndërkohë që shumë të tjerë rezultojnë të zhdukur. Ngjarja bëhet

edhe më tragjike, pasi 24 prej viktimave janë fëmijë. Ndërkohë dyshohet për qindra persona të zhdukur. Po ashtu bëhet e ditur se mes të zhdukurve ka edhe dy shqiptarë.

Greqia po mban një periudhë zie, ndërsa ekipet e shpëtimit vazhdojnë të kontrollojnë makinat dhe

shtëpitë e djegura nga zjarret që kanë shkatëruar gati 80 viktima. Kryeministri Alexis Tsipras njoftoi të martën se do të ketë tri ditë zie kombëtare.

Zjarri më i rëndë u përhap në afërsi të portit të Rafinës, afër Athinës, duke bërë që shumë njerëz të zbrisnin drejt plazheve dhe

REAGIMI I AMBASADËS SHQIPTARE

Ambasada e RSh-së në Athinë njofton se në vijim të verifikimeve në terren rezultoi se një shtetas shqiptar ndodhet në gjendje të rëndë në spitalin Evangelismos. Jemi në ndjekje të situatës duke komunikuar me qytetarë, anëtarë të komunitetit në zonat e prekura të rajonit të Atikës, si dhe me autoritetet kompetente të emergjencës së qeverisë greke.

Njerëzit u detyruan të iknin me shpejtësi ... të rrethuar nga flakët.

Për shumë njerëz i vetmi shpëtim ishte deti. Disa qëndruan në ujë për orë të tëra duke shprehur me dëshpërim të shpëtonin nga ferri i pamëshirshëm.

Dhjetëra vetë janë konfirmuar të vdekur. Viktima më e re, gjashtë muajshe. Shumë u zhdukën kur u bllokuan në trafik. Dita me diell zbuloi një varrezë makinash të djegur që shkakton emocione të forta tek kalimtarët. 65 vjeçari Theodoros Christopoulos përkrahur situatën:

"Ishte një panik i madh pasi e gjithë rruga ishte e bllokuar me makina. Dëgjoje të bërtitura, histeri. Ata e shihnin zjarrin që vinte nga era. Qielli ishte i zi."

Zyrtarët thonë se në një qytezë 26 trupa u gjetën të mbledhur së bashku, duke u përhapur të mbronin njëri-tjetrin.

Bullgaria ka paralajmëruar fqinjët e tyre jugorë

Tejfryrja e lumenjve, pas zjarrit Greqia kërcënohet nga përmytjet



Autoritetet në Bullgari kanë paralajmëruar fqinjët e tyre jugorë, Greqinë dhe Turqinë se mund të përballen me përmytje pas reshjeve të mëdha që priten të tejfryjnë shtretërit e lumenjve Arda dhe Maritsa që rrjedhin në territoret e tyre.

Paralajmërimi vjen ndërkohë që shërbimet greke të emergjencave po luftojnë me flakët në katastrofën më të madhe të viteve të fundit, si pasojë e zjarreve në kryeqytetin Athinë, që i kanë marrë jetën deri më tani disa dhjetëra personave.

Diga Ivailovgrad, në lumin Arda, në malet Rodope në lindje, ka shumë

gjasa të tejmbushët ditët e ardhshme për shkak të reshjeve që priten të bien, tha ministria e Jashtme bullgare. Lumi Arda rrjedh

drejt lindjes në Greqi dhe i bashkohet lumit Maritsa në kufirin greko-turk.

Sofja tha se pret rritje masive të nivelit të ujit në

të dy këto lumenj veçanërisht në afërsi të qytetit bulgar Svilengrad, në afërsi të kufirit turk.


Autoritetet bullgare

AUTORITETET BULLGARE

Diga Ivailovgrad, në lumin Arda, në malet Rodope në lindje, ka shumë gjasa të tejmbushët ditët e ardhshme për shkak të reshjeve që priten të bien, tha ministria e Jashtme bullgare. Lumi Arda rrjedh drejt lindjes në Greqi dhe i bashkohet lumit Maritsa në kufirin greko-turk.

kanë shpallur gjendjen e emergjencës në disa bashki pas shirave të rrëmbyeshëm. Një person humbi jetën pasi u rrëmbye nga ujërat e përmytjeve në qytetin bulgar Teteven, të martën.

Fjalëkryqi (1)



- 38. Fillojnë vonë.
- 39. Krijoi James Bond.
- 40. Ishulli i Odiseut.
- 42. Van der portier.
- 43. Një karamelle aromatike.
- 44. Mund të shkojnë... nga frika.

- VERTIKAL**
- 1. Bëhet duke vënë në lojë.
 - 2. Pak origjinale.
 - 3. Thahet me bonifikim
 - 4. Në fund djathtas.
 - 5. Ishte Gjermania e Honecker-it.
 - 7. Hidhet një për shesh.
 - 9. Kokëkuçja në pit stop.
 - 10. I famshëm ai i Sizifit.
 - 12. Eshhtë në pikën më veriore e Shqipërisë.
 - 13. Një diktator shtypës
 - 14. Lëvizja Socialiste Spanjole.
 - 15. I kanë çift radhët.
 - 16. Janë llahtarë.
 - 17. Poeti kur nuk pi.
 - 19. Fillojnë periudhën.
 - 22. Omar që qe aktor.
 - 24. Si sezonale.
 - 25. Janë banorët në Riga.
 - 26. Carey këngëtare.
 - 27. Nuk i tregohën babait.
 - 29. Kush ka... e ka humbur toruan.
 - 30. Një stacion orbital.
 - 31. Fillojnë profesionin.
 - 33. Gibernau i MotoGp.
 - 34. I kanë të ndryshme tutat
 - 36. Gjysmë ditari.
 - 38. Varet me re.
 - 41. Kufijtë e kuqtesës.
 - 42. Sapo fillojnë.


- VERTIKAL**
- 1. Të çara ato të Shollohov.
 - 5. Fillojë luftën.
 - 6. Liszt kompozitor.
 - 8. Marsi në Areopag.
 - 9. Kështu fillon filmi.
 - 11. Gjysmë linear.
 - 12. Një freskues në tavan.
 - 18. Eshhtë gazeta Panorama.
 - 20. Mund të jenë kamikaze.
 - 21. Masat pa kufij
 - 23. Venier e spektaklit italian.
 - 25. Sophia e kinemasë.
 - 26. Safin tenis.
 - 29. Eshhtë makut, i pangopur.
 - 31. Eshhtë faqe ene.
 - 32. Një kafshë qe hap... galeri.
 - 33. Një fytyrë e keqe.
 - 35. Preken nga sindroma Basedow.
 - 37. Italia në Internet.

Fjalëkryqi (2)


- HORIZONTAL**
- 1. Gustav kompozitor.
 - 6. Në krye të kryesisë.
 - 7. Lexohet në pentagram.
 - 11. Sastre aktore.
 - 12. Gjysmë akordi.
 - 15. Dhjetë angleze.
 - 16. Satira për zë.
 - 18. Eshhtë situata e tensionuar.
 - 21. Pak teatrale.
 - 22. Bëhet me mea culpa.
 - 24. Fundi i një samurai.
 - 25. Mbeten në fund.
 - 26. Lind në kokë.
 - 28. Në radhë të parë.
 - 29. Inicialet e Camus.
 - 30. Një verë në Paris.
 - 31. Partizani i vogël... në një film tonin.
 - 33. Litra pa kufij.
 - 35. Eshhtë fatë.

- HORIZONTAL**
- 36. Një pjesë e kinematografisë.
 - 37. Një pjesë e akademisë.
 - 39. Kufijtë e tretjes.
 - 40. Mbyll të çarën.
 - 41. Erik çiklist.
 - 43. Një pjesë e medaljes.
 - 44. Njësi matëse e shpërthimit atomik.
 - 46. Pak torturuese.
 - 48. Ka privilegjin e jetës
 - 51. Mbyllin një spital.
 - 52. Mbyllet me dorezë.
 - 53. Ishin kalorësit si Rolandi
 - 54. Ndal në... kryqëzim.


- VERTIKAL**
- 1. Janë enigmatikë.
 - 2. Mund të jenë parabolike.
 - 3. Ishte xhelozja e Olimpiti.
 - 4. Kufijtë e lëvizjes.
 - 5. Fillojnë radhitjen.
 - 6. Janë kushte.
 - 8. Të mbyllin kanate.
 - 9. Mbyllin kanate.
 - 10. Shoqëronte Edipin e verbër.
 - 13. Eshhtë gjeli.
 - 14. Moore aktore.
 - 17. Janë forcat e Reneas.
 - 19. Janë përmasa.
 - 20. Fund dhjetori.
 - 23. Mbyllin dritaren.
 - 26. Fillojnë matjet.
 - 27. Duhet ruajtur.
 - 32. I bën një serenatë Rosina-s.
 - 34. Gjysmë rabini
 - 38. Mustafa.. Ataturk.
 - 40. Të parat në Amsterdam.
 - 42. Ai i muzave është Helikona.
 - 45. Një pjesë e gadishullit
 - 47. Muzika e Eminem.
 - 49. Fillojnë operacionin.
 - 50. Kapen të parat.
 - 52. Kufijtë e drejtëzës.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJVE TË NUMRIT TË KALUAR

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A | R | K | A | A | S | T | R | O | A | M | A |
| D | I | A | N | A | H | A | N | T | I | K | |
| A | T | L | A | N | F | I | R | E | O | L | S |
| D | E | I | P | A | R | K | I | F | A | T | L |
| T | T | P | O | L | I | T | I | K | A | N | E |
| P | A | U | L | I | N | E | T | A | O | R | A |
| P | A | U | L | I | N | E | T | A | O | R | A |
| A | K | E | O | T | A | A | D | I | M | | |
| R | U | M | U | N | E | K | I | E | R | A | |
| E | T | I | T | E | R | I | A | M | A | N | |
| T | E | L | G | O | R | D | I | A | N | E | |
| I | N | T | A | R | O | M | A | T | I | T | |
| F | A | E | M | E | L | E | R | G | O | | |
| R | K | U | P | A | E | M | I | R | A | T | E |
| O | H | A | R | A | D | A | R | O | M | A | T |
| C | I | K | L | I | S | T | E | T | | | |
| S | T | A | D | I | U | M | E | T | A | P | E |
| D | I | K | A | S | T | E | R | E | | | |
| K | E | N | T | A | N | G | O | P | J | E | V |
| K | A | T | I | A | S | I | E | E | S | | |
| A | R | N | I | O | L | A | I | R | | | |
| M | A | S | S | I | M | O | Z | A | N | O | R |
| A | M | A | N | A | N | A | N | | | | |
| T | T | E | R | R | E | N | I | E | I | N | E |



SUDOKU

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|--|
| | | 4 | | | | | | | | | |
| | | 6 | 9 | | 4 | | 2 | 5 | | | |
| 7 | 8 | | | | | 3 | | | | | |
| 1 | | | | | | | | | | | |
| | | 2 | | 3 | | 8 | | 7 | | | |
| | 5 | | | | | | | | 3 | | |
| 8 | 5 | | 7 | | | | 3 | 2 | | | |
| | | | | | | | | | | 4 | |
| | | | 8 | 9 | | 6 | | | | | |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 7 | 1 | 4 | 9 | 8 | 3 | 6 | 2 | 5 |
| 8 | 2 | 6 | 1 | 7 | 5 | 9 | 3 | 4 |
| 3 | 9 | 5 | 6 | 4 | 2 | 7 | 8 | 1 |
| 9 | 5 | 3 | 7 | 1 | 6 | 2 | 4 | 8 |
| 2 | 6 | 7 | 8 | 3 | 4 | 1 | 5 | 9 |
| 1 | 4 | 8 | 5 | 2 | 9 | 3 | 6 | 7 |
| 6 | 7 | 1 | 3 | 5 | 8 | 4 | 9 | 2 |
| 4 | 8 | 9 | 2 | 6 | 1 | 5 | 7 | 3 |
| 5 | 3 | 2 | 4 | 9 | 7 | 8 | 1 | 6 |

Argëtim filozofik

- Nëse një pemë bie në pyll dhe askush nuk është atje për ta dëgjuar atë, do të bëjë zhurmë?
- Një hap i vogël për njeriun, një hap i madh për njerëzimin.
- Nuk më shqetësojnë muret që kanë veshë, por veshët që kanë mure...
- Një njeri optimist beson se jetojmë në botën më të mirë të mundshme. Një pesimist ka frikë se kjo është e vërtetë.

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

| | | | | | | | | | | |
|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|
| 12 | 6 | 10 | 2 | | 15 | 10 | | 15 | 1 | 11 |
| 1 | 9 | 3 | 7 | | 8 | | 2 | 7 | 16 | 11 |
| 4 | 1 | 10 | | 5 | 3 | 9 | 3 | 8 | 2 | 12 |
| 2 | 9 | | 16 | 6 | 4 | 2 | 8 | 6 | 9 | 2 |
| 18 | | 12 | 1 | 15 | 2 | 8 | 1 | 11 | 2 | 7 |
| 6 | | 11 | 1 | 15 | 9 | 1 | 8 | | 1 | 8 |
| 4 | 3 | 1 | 1 | 3 | 8 | | 11 | 16 | 8 | 2 |
| 2 | | 7 | 9 | 3 | 2 | 4 | 3 | 8 | 2 | 16 |
| | 15 | 2 | 7 | | | S | O | 10 | 1 | A |
| 7 | 3 | 12 | 9 | 3 | 8 | | 11 | | 17 | 6 |
| 1 | 11 | 3 | | 11 | 6 | 1 | 10 | 9 | 1 | 9 |
| 8 | 3 | 8 | | 1 | 18 | 10 | 3 | 9 | 1 | 3 |

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| M | I | K | E | | K | M | S | | E | | |
| E | K | A | | | R | O | M | A | K | E | T |
| K | M | I | L | I | T | A | N | T | E | T | |
| M | A | T | E | M | A | T | I | K | A | | |
| P | A | S | A | N | I | K | | T | | S | |
| E | K | U | | A | N | E | T | A | R | E | T |
| R | E | T | E | | E | I | R | A | N | I | |
| I | T | R | | B | L | A | K | E | | L | |
| M | I | A | | R | E | D | | E | K | I | |
| E | | M | E | T | A | L | E | | I | S | |
| T | E | K | E | | M | K | U | M | T | | |
| M | O | R | A | V | I | A | | M | A | E | |

Thënie të mençura

- - Shumë justifikime janë gjithmonë më pak bindëse se një.
- - Çdokush që ka përjetuar një dashuri të madhe, nuk i jep rëndësi miqësisë.
- - "Një nga kënaqësitë më të mëdha në jetë, është që të bësh gjëra që të tjerët thonë se ju nuk mundeni".
- - Kushdo që dëshiron, gjen kohë. Kushdo që nuk dëshiron, gjen justifikime.
- - "Njeriu udhëton në jetën e tij duke u justifikuar për të kaluarin, duke u ankuar në lidhje me të tashmen, dhe i frikësuar për të ardhmen."

